



Miratuar më  
23 shtator 2005  
shqip

Takim i Nivelit të Lartë të Ministrave të Brendshëm dhe të Sigurisë si dhe i Zyrtarëve të Lartë të Administratave dhe Qeverive nga Evropa Juglindore

**STRATEGJI RAJONALE MBI  
INSTRUMENTET KUNDËR KRIMIT TË  
ORGANIZUAR DHE KRIMIT EKONOMIK  
ME MASA TË VEÇANTA PËR SECILËN  
ZONË TË PROJEKTIT**

23 SHTATOR 2005  
ISHULLI I BRIJUNIT, KROACI

## PASQYRA E LËNDËS

<b>1</b>	<b>STRATEGJI RAJONALE MBI INSTRUMENTET KUNDER KRIMIT TE ORGANIZUAR DHE KRIMIT EKONOMIK.....</b>	<b>3</b>
1.1	Analiza e krimit dhe e te dhenave mbi krimin .....	3
1.2	Hetimet financiare.....	5
1.3	Mjetet e posaçme hetimore .....	6
1.4	Mekanizmat per mbrojtjen e deshmitareve te krimeve te renda.....	9
1.5	Bashkepunimi ne fushen penale .....	10
<b>2</b>	<b>PERMBLEDHJE E OBJEKTIVAVE TE VEÇANTA PER SECILEN ZONE TE PROJEKTIT .....</b>	<b>12</b>
2.1	SHQIPERIA .....	12
2.2	BOSNJA DHE HERCEGOVINA.....	15
2.3	KROACIA.....	21
2.4	SERBIA DHE MALI I ZI / MALI I ZI .....	24
2.5	SERBIA DHE MALI I ZI / SERBIA.....	27
2.6	SERBIA DHE MALI I ZI / KOSOVA.....	30
2.7	"ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISE".....	32

*Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit CARPO (Zhvillimi I Sistemeve të Besueshme dhe Funksionale të Policive si dhe Nxitja e Luftimit të Aktiviteteve Kryesore Kriminale dhe i Bashkëpunimit Policor) nga ekspertë të Evropës Juglindore dhe nga Këshilli I Evropës, me mbështetjen e vendeve të konsorciumit (Belgjikës, Hungarisë, Finlandës, Italisë, Sllovenisë, Spanjës, Suedisë). Projekti CARPO është financuar bashkërisht nga Komisioni Evropian (90%) dhe nga Këshilli i Evropës (10%).*

# **1 STRATEGJIA RAJONALE MBI INSTRUMENTET KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMIT EKONOMIK**

## **1.1 Analiza e krimit dhe e të dhënave mbi krimin**

*Politikat e kontrollit dhe të parandalimit të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik duhet të mbështeten në një njohje të thellë të asaj se çka përbën krim ekonomik dhe krim të organizuar, sipas standardeve ndërkombëtare, cilat janë fushat, modus operandi dhe prirjet e tregjeve kriminale në një vend të dhënë dhe në rajon – dhe veçanërisht cilat janë degëzimet ndër-kufitare të këtij fenomeni. Një politikë publike e gjithanshme si dhe një aksion kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik duhet të mbështetet në njohje, e rrënjësor në të dhënat mbi këtë fenomen, të cilat mbledhen me anë të një kuadri të strukturuar për mbledhjen, analizimin dhe përpunimin sistematik të të dhënave në pajtim me standardet Evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale.*

*Për pasojë, duhet të ndiqen synimet dhe masat e mëposhtme me qëllim që të përmirësohet kuadri ligjor dhe kapacitetet institucionale në këtë rajon që lidhen me analizën e krimit dhe e të dhënave mbi krimin:*

- Të garantohet një kuadër ligjor për mbledhjen, analizimin, menaxhimin dhe shkëmbimin sistematik të të dhënave që kanë lidhje me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në përfaqje me standardet evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe të sigurohet një kuadër i përshtatshëm për shkëmbimin e informacioneve me vlerë si dhe për përdorimin e burimeve të vlefshme të informacionit
- Të arrihet niveli i duhur i konfidencialitetit në lidhje me depërtueshmërinë tek të dhënat mbi krimin ekonomik dhe krimin e organizuar në pajtim me standardet evropiane mbi fshehtësinë e intimitetit dhe të të dhënave personale.
- Të hartohet një strategji kombëtare/plan veprim për të mbështetur analizën e krimit, nëpërmjet:
  - ngritjes së një sistemi kombëtar (të unifikuar) apo të një rrjeti sistemesh për mbledhjen e të dhënave dhe të statistikave që kanë lidhje me krimin, të cilat duhet të marrin parasysh tiparet specifike të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik
  - përdorimit të një metodologjie të përbashkët për agjencitë e zbatimit të ligjit në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe statistikave mbi krimin, të cilat të marrin parasysh tiparet specifike të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik;
  - garantimit se institucioneve të autorizuara do t'u kërkohet që të raportojnë informacione dhe se ky raportim do të kryhet sipas një formati të standardizuar;
  - analizimit me komunitetet shkencore dhe akademike të aspekteve të krimit të organizuar, prirjeve, rrethanave, grupeve dhe teknologjisë që përdor, si dhe publikimit e analizimit rregullisht të raporteve në këtë fushë;
  - mbështetjes së kërkimeve dhe institucioneve që kryejnë kërkime shumëdisiplinëshe mbi krimin e organizuar dhe krimin ekonomik, duke u dhënë informacione me vlerë si dhe mbështetje tjetër, atëherë kur kjo është e mundur.
- Të monitorohet sistematikisht efektiviteti i masave për parandalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik
- Të ngrihen në nivel kombëtar Njësi për Analizën e Krimit.
- Të zhvillohen trajnime sistematike dhe të vazhdueshme për zyrtarët kompetentë në fushën e analizës së krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik.

- Të përpunohet dhe të përfshihet në strategjitë policore kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, koncepti i “policimit të udhëhequr nga informacioni” dhe të garantohet që të gjitha të dhënat mbi krimin dhe rezultatet e këtyre të dhënave, të përfshihen në punën e policisë në nivel kombëtar dhe lokal.
- Të lehtësohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe i ndërsjellë në fushën e analizës së krimit dhe të informacionit mbi krimin, duke mundësuar nga pikëpamja ligjore dhe operacionale shkëmbimin e informacioneve të vlefshme ndërmjet autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit me qëllim mbledhjen dhe shkëmbimin e informacioneve, hetimin dhe ndihmën ligjore reciproke, në pajtim me rregullat përkatëse që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale.
- Në nivel rajonal të mbështetet përcaktimi dhe miratimi i një metodologjie të përbashkët për mbledhjen e të dhënave si dhe procedurat për shkëmbimin e të dhënave gjatë zhvillimit të hetimeve kriminale ndërkufitare.

## 1.2 Hetimet financiare

*Krimet e rënda, në një masë të madhe nxiten nga përfitimet ekonomike. Vënia në shënjestër e të ardhurave nga krimi në luftimin e korrupsionit, të krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe të formave të tjera të krimit ekonomik, nëpërmjet hetimeve financiare që bëjnë të mundur identifikimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit është një pjesë integrale e çdo strategjie gjithpërfshirëse kundër krimeve të rënda. Vendet e Evropës Juglindore kanë bërë një progres të dukshëm në vitet e fundit duke aderuar në shumë instrumente ligjore ndërkombëtare, dhe në shumicën e rasteve, legjislativi i këtyre shteteve, e parashikon konfiskimin e mjeteve dhe të produkteve të krimit. Sidoqoftë, pranohet gjerësisht se një prej sfidave më të mëdha në këtë drejtim është zbatimi efektiv i këtij legjislativi ekzistues në praktikë.*

*Prandaj, duhet të ndiqen synimet dhe masat e mëposhtëme, me qëllim që të zbatohet në sistemin zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë penale, koncepti i integritetit të hetimeve kriminale dhe atyre financiare, që synojnë konfiskimin e produkteve të krimit.*

- Të forcohet kuadri ligjor që rregullon identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit duke:
  - siguruar një akses efektiv tek burimet e vlefshme të informacionit financiar/bankar (p.sh. duke hequr sekretin bankar);
  - garantuar masa të ndërmjetme në procesin penal, të cilat japin mundësinë për ngrirje ose kapje në një fazë të hershme të procesit të të ardhurave të dyshuara për prejardhje nga krimi;
  - garantuar se të gjitha krimet e rënda hetohen për pastrim parash;
  - garantuar se prokuroria apo gjykata mund të urdhërojnë me nismën e tyre një hetim financiar, brenda një procesi gjyqësor;
  - marrë në konsideratë futjen e parimit të zhvendosjes së barrës së proves, sikurse parashikohet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (KEDNj) pra, në përpjesëtim me rrethanat, në rastet kur vendoset masa e konfiskimit;
  - garantuar se legjislativi dhe procedurat për konfiskimin e produkteve të krimit lejojnë për konfiskimin e bazuar në vlerë si dhe për konfiskimin nga palet e treta *male fide*.
  - konsideruar futjen e një regjimi të zgjeruar konfiskimi.
- Të miratohen strategji të hetimit financiar, të cilat vënë në shënjestër pasuritë e grupeve të krimit të organizuar, nëpërmjet integritetit të hetimeve financiare tek hetimet kriminale dhe duke:

- garantuar se hetimet penale shoqërohen sistematikisht me hetime financiare mbi të ardhurat nga krimi;
  - përpiluar sistematikisht statistika të besueshme, mbi të gjitha hetimet financiare të kryera, të cilat duhet të pasqyrojnë zbatimin e masave të ndërmjetme si dhe të urdhërave për konfiskim
- Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet organeve të ndryshme duke:
    - nxitur një metodologji prej “task force” në hetimin e çështjeve komplekse;
    - garantuar një shkëmbim operacional të të dhënave ndërmjet policisë, prokurorisë, njësive të inteligjencës financiare, autoriteteve të tatim/taksave dhe të doganave dhe organeve të tjera kompetente;
    - garantuar një bashkëpunim ndërkombëtar dhe dypalësh, si dhe shkëmbimin e të dhënave gjatë hetimeve financiare, duke mundësuar bashkëpunimin institucion me institucion.
- Të garantohet specializimi i personave, apo organeve (p.sh. autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit dhe të prokurorëve) në hetimet financiare, duke:
    - siguruar mjetet e duhura dhe programe trajnimi të gjithanshme dhe të vazhdueshme, lidhur me hetimet financiare;
    - garantuar se autoritetet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët kanë mundësi t’u drejtohen specialistëve me ekspertizë financiare, për çështjet që lidhen me hetimin financiar;
    - ngritur njësi të specializuara, ose rrjete ekspertësh në fushën e gjurmimit dhe të identifikimit të të ardhurave nga krimi;
    - ngritur një njësi të inteligjencës financiare, (FIU) për marrjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit që lidhet me pastrimin e produkteve nga krimi.
- Të zhvillohet maksimalisht bashkëpunimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi i ndërsjellë në këtë fushë nëpërmjet:
    - Trajtimin të kërkesave për ndihmë ligjore të ndërsjellë, që kanë lidhje me identifikimin, gjurmimin, ngrirjen apo kapjen ose konfiskimin e të ardhurave prej krimit, me të njëjtën përparësi që u jepet proceseve penale në vend;
    - Miratimit në legjislacionin vendas, apo në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe të dispozitave, të cilat mundësojnë ndarjen e të ardhurave dhe kompensimin e të ardhurave;
    - Duke garantuar se Njësia e Inteligjencës Financiare (FIU) i përmbush standardet e grupit EGMONT dhe bashkëpunon për grumbullimin, analizimin dhe në hetimin e të dhënave të vlefshme, por edhe për shkëmbimin e informacioneve të vlefshme, në mënyrë spontane, ose kur kështu i kërkohet, në kufijtë e të drejtës së zbatueshme vendase.

### 1.3 Mjetet e posaçme hetimore

*Nëse krimi, në të gjitha format dhe variantet e tij moderne, duhet të luftohet në mënyrën e duhur, organet e zbatimit të ligjit, duhet të shfrytëzojnë të gjitha mjetet efikase dhe strategjitë moderne të policimit në procesin e gjurmimit, hetimit dhe dënimit, pa përjashtuar mjetet e posaçme hetimore (përgjimin e telekomunikimeve, mbikqyrjen elektronike, operacionet e fshehta, etj). Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën depërtuese të këtyre mjeteve (që këtej e tutje do të quhen MPH), në të drejtat dhe liritë e individëve, përdorimi i tyre duhet t’u nënshtrohet rigorozisht parimeve të ligjshmërisë, të proporcionalitetit, dhe garancive procedurale. Për zbatimin me efektivitet të të gjitha këtyre masave në pajtim me standardet evropiane të të drejtave të njeriut, vendet duhet të miratojnë një kuadër ligjor gjithpërfshirës, si dhe të ngrenë një strukturë institucionale të përshtatshme, të pajisur me të gjitha mekanizmat efikase të kontrollit, si dhe me personel të shkolluar, për zbatimin praktik të këtyre masave. Akoma më tej, hetimet dhe proceset penale kundër aktiviteteve të krimit të organizuar, shpeshherë implikojnë edhe elementë ndërkufitarë dhe për pasojë bashkëpunimin e organeve të zbatimit të ligjit, dhe autoriteteve të prokurorisë ndërmjet shteteve të ndryshme. Kjo kërkon nga ana e*

*vet, një harmonizim të lartë të (duke u kushtuar vëmendjen e duhur specifike të shteteve dhe të administratave të ndryshme) të rregullave ligjore dhe sidomos të standardeve që i referohen provave, në shtete të ndryshme, si edhe një bashkëpunim të fuqishëm në hetimet ndërkuftare, sidomos kur është fjala për ngritjen e ekipeve të përbashkëta hetimore si dhe shkëmbimin e agjentëve të fshehtë. Vitet e fundit është bërë shumë në drejtim të hartimit dhe të përshtatjes së kuadrit ligjor me standardet evropiane, megjithëse zbatimi i tij në praktikë është shpeshherë i kufizuar, për shkak të mungesës së pajisjeve moderne të përgjimit dhe të vëzhgimit (survejimit), sikurse dhe për shkak të mungesës së rregulloreve të brendshme, udhëzimeve dhe ekspertëve të trajnuar në këtë fushë*

*Për pasojë, duhet të ndiqen synimet dhe masat e mëposhtëme, me qëllim që të përmirësohen kapacitetet në përdorimn e MPH-ve, për gjurmimin dhe hetimin e shkeljeve të rënda penale duke përmirësuar në mënyrë konstante kuadrin rregullator, insitucional dhe operacional si dhe duke respektuar në mënyrë të mjaftueshme të drejtat e njeriut.*

- Të miratohet një kuadër ligjor vendas, gjithpërfshirës që do të rregullojë zbatimin e MPH-ve, duke respektuar parimet e mishëruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, (KEDNj) duke:
  - Mundësuar dhe rregulluar me ligj, i cili të jetë i arritshëm për publikun dhe efektet e të cilit janë të parashikueshme, përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore, (mjetet e fshehta të mbikqyrjes dhe të hetimit) për shkelje të rënda, që përfshijnë shkelje të rënda të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, korrupsionin, trafikimin e qenieve njerëzore dhe pastrimin e parave;
  - Garantuar përdorimin e diferencuar të MPHve dhe parashikueshmërinë e përdorimit të tyre, duke specifikuar me ligj, natyrën dhe kufijtë e përdorimit të një mjeti të caktuar teknik (p.sh. përgjimin e telekomunikimeve, survejimin elektronik, monitorimin e transaksioneve financare) apo jo teknik (p.sh. dislokimin e agjentëve të fshehtë, burimet njerëzore të maskuara, etj);
  - Miratuar garanci që do të sigurojnë se zbatimi i MPH-ve, është i kufizuar vetëm për rastet kur përdorimi i këtyre mjeteve është proporcional dhe i domosdoshëm për shkak të seriozitetit të veprës penale si dhe për shkak të vështirësive apo rreziqeve në mbledhjen e informacionit dhe të provave, vetëm me anë të mjeteve të tjera me karakter më pak depërtues në jetën private;
  - Garantuar se ka një kuadër ligjor të hollësishëm që rregullon përdorimin dhe zbatimin e MPH-ve (rregulloret të kenë një formë që ka fuqinë e ligjit, të bëjnë diferencime ndërmjet tipeve të ndryshme të MPH-ve, dhe sidomos të parashikojnë kushtet e përdorimit të tyre, të specifikojnë subjektet, kundër të cilëve mund të autorizohet përdorimi i MPHve, të specifikojnë veprat penale për të cilat po ashtu mund të vendoset përdorimi i MPHve, të përcaktojnë kohëzgjatjen e tyre të lejueshme, kufijtë dhe mënyrën e survejimit, etj.);
  - Miratuar rregullore të hollësishme që trajtojnë menaxhimin dhe shkatërrimin e materialit dhe të të dhënave personale të marra, si rezultat i përdorimit të MPHve, sikurse dhe mundësinë e njoftimit të menjëhershëm të objektit të survejimit;
  - Ndaluar dhe sanksionuar me ligj, që zyrtarët e zbatimit të ligjit ose agjentët të ndërmarrin me iniciativën e tyre veprime që do të rezultojnë në futjen në kurth dhe në provokimin e ndonjë individi për kryerje të veprës penale;
  - Garantuar dhënien e llogarisë lidhur me autorizimin dhe përdorimin e survejimit si dhe mundësinë e rishikimit dhe të kontrollit të përdorimit të MPHve brenda strukturës së prokurorisë dhe organeve të zbatimit të ligjit;
  - Garantuar mbikqyrjen e gjykatës mbi procesin e urdhërimit dhe të zbatimit të MPHve që depërtojnë në jetën private të individit;
  - Garantuar, duke pasur parasysh edhe garancitë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pranueshmërinë në gjykatë të provave dhe të informacionit të mbledhur si rezultat i përdorimit të MPHve, duke quajtur njëherazi të papranueshme provat dhe materialet të

mbledhura nëpërmjet përdorimit të paligjshëm të MPHve në kundërshtim me kriteret ligjore që nevojiten për përdorimin e tyre;

- Garantuar, në pajtim me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që mbrojtja të ketë mundësinë ta shqyrtojë materialin e mbledhur si rezultat i përdorimit të MPHve si dhe të ketë mundësinë e kundërshtimit të ligjshmërisë së tyre, me anë të procedurave gjyqësore.
- Të formulohen dhe të miratohen rregullore dhe udhëzime për organet e zbatimit të ligjit të përfshira në përdorimin dhe vënien në zbatim të MPHve duke:
  - Miratuar udhëzime të brendshme të hollësishme / akte nënligjore që rregullojnë procedurat e brendshme të autorizimit, rregullat për mbajtjen e dosjeve si dhe rregullat që lidhen me menaxhimin e materialit të përfituar, masat që sigurojnë konfidencialitetin e hetimeve si dhe të tjera parime udhërrëfyese, të cilat organet e zbatimit të ligjit duhet t'i aplikojnë gjatë përdorimit të këtyre mjeteve dhe të rezultateve të tyre;
  - Miratuar udhëzime dhe rregullore të brendshme për drejtimin e operacioneve të fshehta, duke përfshirë rregullat, të cilat duhen ndjekur si nga agjentët e fshehtë në veprim, ashtu edhe nga zyrtarët e zbatimit të ligjit të ngarkuar me menaxhimin dhe drejtimin e agjentëve të fshehtë;
  - Miratuar udhëzime të brendshme për zyrtarët e zbatimit të ligjit që punojnë me informatorët e regjistruar.
- Të krijohet një sistem kombëtar raportimi në lidhje me përdorimin e (MPHve) duke:
  - Mbledhur dhe analizuar sistematikisht informacionet mbi përdorimin e MPHve;
  - Garantuar që një autoritet i lartë dhe i pavarur të raportojë çdo vit, lidhur me përdorimin e të gjitha llojeve të MPHve;
  - Identifikuar praktikat më të mira që kanë lidhje me rolin e gjyqësorit dhe të organeve të zbatimit të ligjit të përfshira në përdorimin e MPHve dhe në kontrollimin e tyre;
  - bërë publike raportet vjetore statistikore mbi përdorimin e MPHve.
- Të rregullohet përdorimi i burimeve financiare në zbatimin e MPHve duke miratuar një kuadër (të brendshëm) të hollësishëm të rregullave, që qeverisin sferën e përdorimit të burimeve financiare (që mund të jetë p.sh. një fond special) të angazhuara në përdorimin e MPHve, duke pasur në konsideratë të veçantë financimin e operacioneve të fshehta, të agjentëve dhe të informatorëve, si dhe të garantohet një kontroll efikas mbi mënyrën e harxhimit të këtyre fondeve.
- Të garantohet që MPH-të, kur përdoren për qëllime të hetimeve penale, vihen në zbatim nga një personel i specializuar dhe i trajnuar nga rradhët e organeve të zbatimit të ligjit duke:
  - Ngritur njësi / departamente të specializuara për përdorimin e MPHve në kuadër të autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe duke garantuar një pavarësi të vërtetë operacionale të këtyre njësive/departamenteve;
  - Garantuar shkëputjen ligjore dhe institucionale të mbikqyrjes që kryhet nga autoritetet e zbatimit të ligjit, për qëllime të procesit penal, nga mbikqyrja (survejimi) që kryejnë shërbimet e fshehta të inteligjencës për qëllime të sigurisë kombëtare, si dhe të garantohet që organet e zbatimit të ligjit të pajisen me burime njerëzore dhe teknike, që u mundësojnë atyre përdorimin e MPHve në mënyrë të pavarur nga institucionet apo burimet e sigurimit të shtetit.
- Të parashikohet një sistem i përgjithshëm kombëtar për kontrollin efikas (përveç atij që realizohet me anë të autorizimit/apelimit gjyqësor dhe të prokurorit) mbi përdorimin e MPH-ve, ose nëpërmjet paneleve të posaçme gjyqësore, ose nëpërmjet komisioneve parlamentare, ose nëpërmjet Ombudsmanit.

- Të garantohet bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet prokurorisë dhe policisë në procesin e përdorimit dhe zbatimit të MPHve.
- Të institucionalizohen dhe të nxiten trajnime të vazhdueshme profesionale që lidhen me teknikat e posaçme hetimore dhe të inteligjencës, duke:
  - Institucionalizuar një program trajnimesh të gjithanshme dhe të përgjithshme mbi përdorimin e MPHve për zyrtarët kompetentë, të përfshirë në përdorimin e MPHve dhe në kontrollin e tyre;
  - Institucionalizuar një program trajnimesh specifike për agjentët e fshehtë dhe për zyrtarët e zbatimit të ligjit të ngarkuar me menaxhimin dhe drejtimin e agjentëve të fshehtë.
- Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar në lidhje me përdorimin e MPHve duke:
  - Shfrytëzuar në maksimum mundësitë që ofrohen nga instrumentet ekzistuese ndërkombëtare në lidhje me përdorimin e MPHve, në mënyrë të veçantë mundësitë që ofron Konventa Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë Ligjore në Fushën Penale dhe protokollet e saj;
  - Të realizohen në praktikë ekipet e përbashkëta hetimore si dhe operacionet ndërkufitare në lidhje me përdorimin e MPHve, duke përfshirë mundësinë e shkëmbimit të agjentëve të fshehtë.

#### 1.4 Mekanizmat për mbrojtjen e dëshmitarëve të krimeve të rënda

*Një sistem kompleks i masave që mundësojnë mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, para, gjatë dhe pas procesit penal, ka rezultuar një instrument themelor në hetimin me sukses dhe dënimin e krimeve të rënda sikurse dhe një detyrim që lind për drejtësinë penale në prizmin e mbrojtjes së viktimave të prekshme të një krimi, sic mund të jenë për shembull viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Një game e gjerë masash procedurale dhe jo-procedurale është e domosdoshme për të garantuar që dëshmitarët të dëshmojnë lirisht dhe të pafrikësuar, të bindur, se jeta e tyre, e të afërmeve të tyre apo personave me të cilët janë të lidhur ngushtë, është e mbrojtur para, gjatë dhe pas procesit penal. Një progres i admirueshëm është bërë gjatë dy viteve të fundit në Evropën Juglindore, ku shumica e shteteve dhe e administratave kanë miratuar së fundmi një legjislacion të caktuar mbi mbrojtjen e dëshmitarit si dhe kanë ngritur njësi speciale për mbrojtjen e dëshmitarëve. Sfidat që tani shtrohet është që këto njësi të bëhen plotësisht operacionale dhe që programet për mbrojtjen e dëshmitarit të marrin financime të mjaftueshme si dhe të integrohen në rrjetet dhe sistemet evropiane që lidhen me mbrojtjen e dëshmitarit. Ligjet, të cilat përmbajnë masat procedurale, po ashtu ekzistojnë në rajon, por përmirësimi i zbatimit të tyre në praktikë kërkon trajnim të mëtejshëm të lojtarëve kompetentë të sistemit të drejtësisë penale si dhe sigurimin e aksesit tek sistemet moderne të telekomunikimit të domosdoshme për paraqitjen e dëshmitarëve me anë të videos.*

*Në vijim të kësaj, do të ndiqen masat dhe synimet e mëposhtme në dobi të ndërtimit të një sistemi të gjithanshëm për mbrojtjen e dëshmitarit, për viktimat e prekshme dhe për bashkëpunëtorët e drejtësisë:*

- Të miratohet një kuadër ligjor gjithpërfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën policore bazë, si dhe për masat procedurale, jo-procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve duke:
  - Garantuar në ligj se zyrtarët e zbatimit të ligjit kanë mundësinë, por dhe detyrimin që të ofrojnë mbrojtje ad hoc dhe asistencë të gjithë dëshmitarëve dhe viktimave, sipas nevojave;
  - Përfshirë një game të gjerë masash procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve gjatë procesit penal dhe duke garantuar në përputhje me standardet e Konventës Evropiane



për të Drejtat e Njeriut, se zbatimi i këtyre masave është në përpjestim me të drejtat e mbrojtjes;

- Përfshirë një game të gjerë masash jo-procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve, para, gjatë dhe pas procesit penal, me anë të një programi për mbrojtjen e dëshmitarëve, i cili mund të parashikojë transferimin e dëshmitarit apo ndryshimin e identitetit të tij si dhe masa të tjera mbrojtëse urgjente;
  - Mundësuar ekzistencën dhe përdorimin e teknologjisë moderne të komunikimit për dëshminë e paraqitur nga dëshmitarët;
  - Garantuar hetim dhe denim efikas të të gjitha formave të kërcënimit, presionit ose frikësimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë;
  - Garantuar që bashkëpunëtorët e drejtësisë të përfitojnë nga masat mbrojtëse procedurale dhe jo-procedurale në favor të dëshmitarëve, por edhe nga masa të tjera të veçanta mbrojtjeje, të konceptuara posaçërisht për bashkëpunëtorët e drejtësisë.
- Të miratohet një strategji kombëtare gjithpërfshirëse / program për mbrojtjen e dëshmitarit, ku të përfshihet bashkëpunimi dy-palësh dhe ndërkombëtar në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarit.
  - T'u garantohet dëshmitarëve që janë viktimave të prekshme, siguri, strehim, ndihmë mjekësore dhe mundësia për të marrë këshillim ligjor.
  - Të caktohet si përparësi dhënia e financimeve të vazhdueshme për programet e mbrojtjes së dëshmitarëve.
  - Të ngrihen njësi të specializuara për mbrojtjen e dëshmitarit dhe të garantohen trajnime të përshtatshme fillestare për personelin e tij;
  - Të garantohen parakushtet e domosdoshme për trajnim të specializuar të personelit të organeve të zbatimit të ligjit, prokurorisë, gjyqësorit, përgjegjës për zbatimin e mbrojtjes së dëshmitarit dhe të garantohen trajnime të vazhdueshme dhe të qëndrueshme në këtë fushë.
  - Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë duke:
    - Lehtësuar marrjen në pyetje të dëshmitarëve përtej kufijve si dhe të krijohet mundësia e zbatimit të programit për mbrojtjen e dëshmitarit përtej kufijve;
    - Vënë në dispozicion dhe në përdorim mjetet moderne të telekomunikimit, duke dhënë ndihmë në transferimin e dëshmitarit jashtë shtetit, duke shkëmbyer informacion, etj;
    - Duke u bërë pale e marrëveshjeve dypalëshe, ose shumëpalëshe, të cilat parashikojnë se skemat/programet vendase për mbrojtjen e dëshmitarit janë të vlefshme edhe për dëshmitarët e huaj.

## 1.5 Bashkëpunimi në fushën penale

*Krimi i organizuar ndërkufitar është një sfidë që shtetet nuk mund ta përballojnë të vetme. Prandaj, bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale luan një rol kyç në kuadrin e përgjithshëm të marrëdhënieve ndërmjet shteteve, qoftë në nivel evropian, qoftë në nivel ndërkombëtar. Ky bashkëpunim mund të marrë forma të ndryshme, si për shembull atë të bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, ndihmën e ndërsjelltë në hetimin dhe dënimin e çështjeve, si dhe ekstradimin e kriminelëve të mundshëm, ku secila prej këtyre formave është një mjet efikas në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar dhe krimit ekonomik.*

*Vitet e fundit, vendet dhe administratat e Evropës Juglindore kanë bërë një progres të dukshëm duke aderuar në instrumente evropiane dhe ndërkombëtare, të cilat e lehtësojnë bashkëpunimin në fushën penale, sikurse dhe duke nënshkruar një numër të madh marrëveshjesh dypalëshe. Por, duhet pranuar, megjithatë, se aktualisht shtetet kanë kapacitete të ndryshme që mund t'i angazhojnë në*

*bashkëpunimin ndërkombëtar dhe bashkëpunimit të ndërsjellë si dhe kanë ende nevojë për t'i eksploruar në thellësi këto forma të bashkëpunimit. Sfida që del përpara është që të ngrihet një sistem funksional i bashkëpunimit ndërkombëtar duke eliminuar pengesat ligjore dhe praktike, dule garantuar që legjislati vendas të krijojë mundësitë që marrëveshjet ndërkombëtare dhe detyrimet që burojnë prej tyre të përmbushen plotësisht, duke zhvilluar kapacitetet operationale të gjyqësorit dhe të organeve të zbatimit të ligjit, duke shkëmbyer informacione, duke rritur profesionalizmin e autoriteteve kompetente me anë të programeve të gjera trajnimesh, me anë të përvojës dhe ekspertizës. Akoma më tej, zhvillimet e reja ligjore në nivelin e Bashkimit Evropian në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale duhet të merren në konsideratë, në procesin e planifikimit të masave ligjore dhe institucionale për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar*

*Në vijim të sa u tha më sipër, duhet të ndiqen masat dhe synimet e mëposhtëme me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve në dobi të krijimit të një sistemi funksional të bashkëpunimit në fushën penale:*

- Të nënshkruhen dhe të ratifikohen sa më shpejt të jetë e mundur instrumentet ligjore evropiane dhe ndërkombëtare që kanë si qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet policive dhe gjyqësorit në dobi të zgjerimit të sistemit ndërkombëtar të bashkëpunimit në fushën penale;
- Të përfundohen marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe ose pakte me qëllim realizimin dhe rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit në fushën penale si dhe të merren masa për lehtësimin e operationeve të përbashkëta ndërmjet policive apo organeve të zbatimit të ligjit, të cilat mund të përfshijnë edhe oficerë ose gjyqtarë të huaj të ndërlidhjes (koordinatorë), si dhe të konsiderohet mundësia e dërgimit të oficerëve apo gjyqtarëve vendas në shtetet e tjera;
- T'i jepet mundësia njëri-tjetrit për të përfituar nga shkalla më e lartë e bashkëpunimit dhe e ndihmës së ndërsjellë në fazën e hetimeve, vënies përballë përgjegjësisë penale dhe gjatë procesit gjyqësor.
- Të zhvillohen dhe të shkëmbehen praktikatat e mira dhe ekspertiza në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale kundër kimit të organizuar dhe krimit ekonomik.
- Të zbatohen plotësisht instrumentet ligjore evropiane dhe ndërkombëtare, që rregullojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale, duke përmirësuar dhe përqasur sipas nevojave legjislativin kombëtar, duke eliminuar pengesat që bllokojnë bashkëpunimin efektiv.
- Të ngrihet një sistem kombëtar bashkëpunimi efikas me qëllim që të garantohet një bashkëpunim efektiv ndërmjet policisë dhe gjyqësorit, shkëmbimi i të dhënave dhe bashkëpunimi në nivel kombëtar.
- Të garantohet identifikimi dhe caktimi i pikave të kontaktit për qëllime të bashkëpunimit gjyqësor dhe policor duke:
  - Caktuar një autoritet qendror përgjegjës për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar;
  - Caktuar një autoritet qendror përgjegjës për bashkëpunimin policor ndërkombëtar.
- Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve qendrore duke:
  - Ngritur dhe zhvilluar rrjete operationale të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve qendrore të caktuara dhe partnerëve të tyre në shtete të tjera dhe duke zhvilluar modalitetet praktike të bashkëpunimit të tyre;
  - Caktuar metodat dhe kanalet për një bashkëpunim ndërkombëtar të drejtpërdrejtë dhe të zhdërvjellët si dhe për shkëmbimin e informacioneve apo të të dhënave të shërbimeve të inteligjencës.

- Të institucionalizohen programe të gjera trajnimi për profesionistët, të përfshirë në bashkëpunimin ndërkombëtar gjyqësor dhe policor.

## **2 PERMBLEDHJE E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE PER SECILEN ZONE TE PROJEKTIT**

### **2.1 SHQIPERIA**

#### **1. Rrijta e kapaciteteve për analizën e krimit dhe të të dhënave mbi krimin**

*Objektivat afatshkurtra / afatmesme:*

Kuadri ligjor:

- Të zbatohen dispozitat e Konventës për Mbrojtjen e Individëve në raport me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale si dhe të Protokollit Shtesë të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në raport me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, që i referohet autoriteteve mbikqyrëse dhe kalimit ndërkufitar të të dhënave.

Kuadri Institucional:

- Të forcohen njësitet për analizën e krimit: nëpërmjet trajnimeve mbi analizën e krimit ekonomik dhe të krimit të organizuar;
- Të ngrihet një sistem kombëtar (i njësuar) ose një rrjet i njësuar sistemesh për grumbullimin e të dhënave dhe statistikave që kanë lidhje me krimin, të cilat duhet të marrin parasysh tiparet specifike të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik;
- Të përpunohet një metodologji e përbashkët për agjencitë e zbatimit të ligjit për mbledhjen e të dhënave dhe të statistikave që kanë lidhje me krimin, e cila duhet të marrë parasysh tiparet specifike të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik;
- Të garantohet që kontributi standard i informacionit të jetë i detyrueshëm për institucionet e caktuara të zbatimit të ligjit.

*Objektivat afatgjata:*

Politikat

- Të bashkëpunohet me komunitetet akademike dhe shkencore (si psh. Akademia e Policisë dhe Fakulteti i Krimnologjisë) për të analizuar aspektet e krimit të organizuar, prirjet e tij, rrethanat në të cilat zhvillohet, grupet dhe teknologjitë që përdor.
- Të mbështetet zhvillimi i kërkimeve të pavaruara dhe i institucionve që kryejnë kërkime shumë-disiplinëshe mbi krimin e organizuar dhe krimin ekonomik duke u dhënë informacionet e duhura si dhe çdo lloj ndihme tjetër të mundshme.
- Të parashikohet monitorimi sistematik i efektivitetit të masave që kanë lidhje me parandalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik (si p.sh. me anë të raporteve vjetore, apo të një kontrolli parlamentar ose kontrollit të specializuar ndër-institucional).

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e analizës së krimit, duke mundësuar nga pikëpamja ligjore dhe operationale shkëmbimin e informacioneve të vlefshme, ndërmjet autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit me qëllim grumbullimin dhe shkëmbimin e informacioneve, zhvillimin e hetimeve dhe ndihmën e ndërsjellë ligjore, në pajtim me rregullat përkatëse që lidhen me mbrojtjen e të dhënave.

## **2. Fuqizimi i kapaciteteve të hetimeve financiare që synojnë konfiskimin e produkteve të krimit**

*Objektivat afatshkurtra / afatmesme:*

- Të rritet ndërgjegjësimi i mëtejshëm mbi konceptin e hetimeve financiare ndërmjet policëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Të rritet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet policisë dhe prokurorisë nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet këtyre institucioneve, të cilat duhet të specifikojnë hollësisht mënyrat në të cilat policia dhe prokuroria funksionojnë dhe bashkëpunojnë në fushën e hetimeve financiare;
- Të kryhen trajnime të përbashkëta për oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët të cilat duhet të përqendrohen në njohjen më të mire të konceptit të hetimit financiar si dhe në kuadrin ligjor që ekziston në këtë fushë në Shqipëri dhe mbi instrumentet ligjore evropiane dhe ndërkombëtare;
- Të krijohet Njësia e Policisë Gjyqësore brenda Administratës së Taksave

*Objektivat afatgjata:*

- Të zgjerohen kompetencat e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Konfiskuara dhe të Sekuestruara, që duhet të përfshijë jo vetëm pasuritë e krimit të organizuar, por edhe pasuritë e formave të tjera të krimit;
- Të bëhen shtesa në Kodi i Procedurës Penale duke mundësuar monitorimin e fshehtë të transaksioneve bankare;
- Të ndryshohet Kodi i Procedurës Penale ku të përfshihet detyrimi për Policinë Gjyqësore që të nisë bashkë me hetimin penal për vepra të rënda penale, edhe hetimin financiar, që synon të identifikimin dhe sekuestrimin e produkteve të krimit;
- Të krijohet një rrjet rajonal i shkëmbimit të informacionit në lidhje me hetimin financiar, ndërmjet agjencive të ndjekjes penale në rajon që do të nxisë bashkëpunimin rajonal në këtë fushë. Të mbështeten kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet institucioneve hetimore dhe të prokurorisë si dhe ndërmjet ekspertëve nga vende të ndryshme, sidomos për çështje që lidhen me krimet në fushën e doganave, krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, etj.

## **3. Forcimi i kuadrin ligjor dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale që lidhen me përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore**

- Të shtohen dispozita të reja në Kodin e Procedurës Penale, që do të heqin kufizimin, sipas të cilit vetëm oficerët e policisë gjyqësore mund të jenë agjentë të fshehtë;
- Të shtohen dispozita të reja në Kodin e Procedurës Penale të cilat do të parashikojnë përdorimin e masave për mbrojtjen e dëshmitarit edhe në raport me dëshminë e agjentëve të fshehtë;
- Të miratohen rregullore të brendshme/akte nënligjore, që do të rregullojnë procedurat e brendshme të autorizimit, rregullat për mbajtjen e dosjeve, rregullat për menaxhimin e materialit të përfituar si rezultat i përdorimit të MPHve, masat që sigurojnë konfidencialitetin e hetimeve, dhe parime të tjera udhërrëfyese, duke përfshirë modele standarde të kërkesës dhe të autorizimit për përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore;
- Të miratohen udhëzime të brendshme dhe rregullore që mbulojnë: a) procedurat e menaxhimit të operacioneve të fshehta, duke përfshirë rregullat për përzgjedhjen e agjentëve të fshehtë, rregullat për drejtimin dhe sjelljen e tyre; b) masa standarde në lidhje me ekzekutimin e veprimeve simuluese (pseudo-blerjet, veprat pseudo korruptive etj) në rastet e korrupsionit dhe të krimit të organizuar;
- Të miratohen udhëzime të brendshme për zyrtarët e zbatimit të ligjit që punojnë me informatorët e regjistruar;
- Të krijohet një sistem kombëtar raportimi mbi përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore (MPHve);
- Të miratohet një kuadër ligjor (i brendshëm) që rregullon përdorimin e burimeve financiare që lidhen me financimin e operacioneve të fshehta, agjentëve dhe informatorëve si dhe të sigurohet një kontroll efikas mbi përdorimin e këtyre fondeve;

- Të studiohen modele të ndryshme të mekniizmave të jashtëm të kontrollit, me qëllim që të parashikohen mekanizma të jashtëm dhe efektivë mbi përdorimin e MPHve (përveç mbikqyrjes dhe kontrollit që ushtron gjykata), që mund të jenë ose një panel i posaçëm gjyqësor, ose një komitet parlamentar i veçantë, ose Avokati i Popullit apo ndonjë organ tjetër;
- Të institucionalizohen trajnime të përgjithshme mbi përdorimin e MPHve, për zyrtarët e zbatimit të ligjit, prokurorët, gjyqtarët, etj;
- Me asistencën e ekspertëve të huaj dhe të njësive të huaja të specializuara të trajnohen trajnerë, në fushën e dislokimit dhe të drejtimit të agjentëve të fshehtë;
- Në varësi të burimeve materiale në dispozicion, të ngrihet një qendër kombëtare përgjimi vetëm për qëllime të hetimit penal, e cila duhet të jetë institucionalisht e ndarë nga qendra e përgjimeve për qëllime parandaluese;
- Të përmirësohet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e përdorimit të MPHve, sidomos në fushën e shkëmbimit të agjentëve të fshehtë si dhe të lehtësohen ekpjet e përbashkëta për hetimet ndërkufitare, dhe në veçanti në rastet e përdorimit të mjeteve të posaçme hetimore.

#### **4. Krijimi i mekanizmave efektive për mbrojtjen e dëshmitarëve të krimeve të rënda**

- Të fuqizohet njësia ekzistuese për mbrojtjen e dëshmitarit, duke garantuar financime të vazhdueshme, personel të trajnuar dhe pajisjet e duhura;
- Të zhvillohen trajnime për prokurorët dhe gjyqtarët në fushën e masave mbrojtëse procedurale;
- Me ndihmën e ekspertëve të huaj dhe të njësive të huaja të specializuara, të zhvillohet një seri kursesh për trajnim trajnerësh në fushën e masave procedurale dhe jo-procedurale me temë mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë;
- Të lehtësohet përdorimi në praktikë, i teknologjisë moderne të komunikimit (në veçanti pajisjet për videokonferencë) për dhënien e dëshmisë në distance, nga dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, duke vënë në dispozicion pajisje dhe trajnime për personelin përgjegjës;
- Të ngrihet një ose disa pika stacionare për përdorimin e pajisjeve të videoconferences, që do të lehtësonte pyetjen e dëshmitarëve përgjatë kufijve;
- Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë me anë të miratimit të marrëveshjeve dypalëshe dhe rajonale si dhe duke lehtësuar marrjen në pyetje të dëshmitarëve përtej kufijve dhe zbatimin e programeve për mbrojtjen e dëshmitarëve përtej kufijve.

#### **5. Forcimi i kapaciteteve për bashkëpunimin në fushën penale, me theksin tek Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale**

Kuadri ligjor:

- Të hiqet dispozita që parashikon kriminalitetin e dyfishtë në raport me Ndhimën e Ndërsjellë Ligjore në Kodin e Procedurës Penale;
- Në raport me ndihmën e ndërsjellë ligjore në fushën penale, të miratohet legjislacioni përkatës që do të mundësonte dhe lehtësonte praninë e zyrtarëve të Palës kërkuese gjatë kryerjes së veprimeve të kërkuara;
- Në lidhje me komunikimin e drejtpërdrejtë me autoritetet e huaja gjyqësore, të merret në konsideratë paraqitja e një deklaratë që do ta shtrinte autoritetin gjyqësor përtej Ministrisë së Drejtësisë (që do të thotë, marrja në konsideratë e tërheqjes së rezervës së paraqitur nga Shqipëria në raport me Protokollin e Dytë Shtesë, sipas së cilës, Shqipëria njeh si "autoritet të huaj gjyqësor" vetëm Ministrinë e huaja të Drejtësisë);
- Të merret në konsideratë miratimi i legjislacionit përkatës që do të mundësonte zbatimin e nenit 11 që i referohet informacionit spontan.

Kapacitetet Institucionale

- Të zhvillohen trajnime për zyrtarët kompetentë të përfshirë në bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale;
- Të sigurohen burime të mjaftueshme financiare që do të garantonin efektivitetin e duhur të dispozitave të Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës Evropiane për Ndhimë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS 182).

## 2.2 BOSNJA DHE HERCEGOVINA

### 1. Rritja e kapaciteteve për analizën e krimit dhe të të dhënave mbi krimin

Kuadri Ligjor

*Objektivat afat shkurtra dhe afat mesme*

- Të ratifikohen dispozitat e Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe Protokollit Shtesë së Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse dhe kalimin përmes kufijve të të dhënave;

Kuadri Institucional

*Objektivat afat shkurtra dhe afat mesme*

- Të forcohen njësitë e analizimit të krimit duke rekrutuar një numër të përshtatshëm analistësh dhe duke siguruar trainimime në lidhje me analizimin e krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të ngrihet një sistem (i njësuar) kombëtar ose një rrjet sistemesh për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave kriminale të cilat marrin në konsideratë tiparet specifike të krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të zvillohet një metodologji e përbashkët për agjensitë e zbatimit të ligjit për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave kriminale të cilat marrin në konsideratë tiparet specifike të krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të sigurohet në mënyrë të detyrueshme kontributi standart i informacionit në bazën e të dhënave të policisë kriminale;
- Të ngrihet kontrolli i brëndshëm i detyrueshëm në institucione/agjensi në të cilat ende nuk ekziston, dhe të rritet ky kontroll në institucionet ku tashmë është në funksionim;
- Të rriten kapacitetet e stafit të ministrive kompetente (Ministria e Sigurisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Civile) dhe të arrihet afirmimi i plotë i tyre në ushtrimin e kompetencave të parashikuara.

*Objektivat afat gjata*

Politika

- Të bashkëpunohet me komunitetin shkencor dhe akademik (p.sh. Akademia e Policisë dhe Fakulteti i Kriminologjisë) për analizimin e aspekteve të krimit të organizuar, tendencave, rrethanave, grupeve dhe teknologjive;
- Të mbështetet zhvillimi i kërkimeve të pavarura dhe institucioneve, të cilat ndërmarrin studime në fusha të ndryshme në lidhje me krimin e organizuar dhe ekonomik, duke u siguruar informacion të përshtatshëm dhe lloj tjetër ndihme kur është e mundur;
- Të futet monitorimi i rregullt i efektshmërisë së masave për ndalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe ekonomik (p.sh. raporte vjetore dhe mbikëqyrje të posaçme ndër –institucionale dhe parlamentare).

Bashkëpunimi ndërkombëtar

- Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e analizimit të krimit nëpërmjet mundësimit të këmbimit në mënyrë të ligjshme dhe operacionale të informacioneve të përshtatshme midis autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit, me qëllim mbledhjen dhe ndarjen e informacionit, hetimeve dhe ndihmës së përbashkët ligjore, në përputhje me rregullat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave.

### 2. Forcimi i kapaciteteve të hetimeve financiare me synim konfiskimin e produkteve të krimit

#### Kuadri Ligjor

##### *Objektivat afat shkurtra dhe afat mesme*

- Të harmonizohet legjislacioni penal me Konventën mbi pastrimin e parasë, kontrollin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave të krimit dhe Konventën e të Drejtës Penale dhe Konventën e të Drejtës Civile mbi Korrupsionin, në fusha ku ky harmonizim nuk është kryer ende.

##### *Objektivat afat gjata*

- Të miratohet një Ligj i veçantë mbi Konfiskimin e të Ardhurave të Krimit me qëllim sqarimin dhe specifikimin e procedurave të parashtruara në Kodin e Procedurës Penale në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave të krimit.

#### Kuadri Institucional

##### *Objektivat afat shkurtra dhe afat mesme*

- Të rritet bashkëpunimi midis Agjencisë Shtetërore të Hetimeve dhe Mbrojtjes (Departamenti i shërbimit informativ financiar dhe Departamenti i shërbimit informativ kriminal) dhe Ministrive të Brendshme të kantoneve, Policisë së Rrethit të Brcko-s dhe Zyrës së Prokurorisë së BH.
- Të rritet bashkëpunimi midis Administratës së Taksave të Tërthorta (Departamenti për zbatimin e rregulloreve të doganave dhe të taksave) dhe institucioneve të tjera të përfshira në hetime financiare (AShHM, Shërbimi Kufitar i Shtetit, Administratat e Taksave në Kantone dhe Administrata e Taksave në Rrethin e Brcko-s);
- Të përshpejtohet ndërtimi i një baze të njësuar të dhënash rreth regjistrimit të kompanive në regjistrin gjyqësor; si dhe ndërtimi i bazave të tjera uniforme të të dhënave të cilat mund të përdoren lehtësisht nga të gjithë institucionet e përmëndura;
- Të mundësohet specializimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët do të punojnë me hetimet financiare të veprave penale në fushën e krimit të organizuar dhe ekonomik dhe mundësimi i edukimit në këto fusha;
- Të organizohen trainimeve për zyrtarët e autorizuar të zbatimit të ligjit, dhe zyrtarët në agjensi të tjera që merren me hetimet financiare, duke përfshirë dhe gjykatësit dhe prokurorët që merren me hetime financiare;
- Të ngrihet kontrolli i brëndshëm i detyrueshëm në institucione/agjensi në të cilat ende nuk egziston, dhe të rritet ky kontroll në institucionet ku tashmë është në funksionim;
- Të rriten kapacitetet e stafit të ministrive kompetente (Ministria e Sigurisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Civile) dhe të arrihet afirmimi i plotë i tyre në ushtrimin e kompetencave të parashikuara.

##### *Objektivat afat gjata*

- Të ngrihet një Agjensi e specializuar e cila do të merret me menaxhimin e të ardhurave të sekuestruara dhe të konfiskuara të krimit.

### **3. Forcimi i kuadrit ligjor dhe i kapaciteteve zbatuese në lidhje me përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore**

#### Kuadri Ligjor

##### *Objektivat afat shkurtra dhe afat mesme*

- Të adoptohen udhëzime/akte nën-ligjore të brëndshme që rregullojnë: procedurat e autorizimit të brëndshëm, aproviminin e mjeteve të posaçme të hetimit (MPH), rregullat e mbajtjes së të dhënave dhe rregullat e trajtimit të materialeve të siguruara, masat që sigurojnë fshehtësinë e hetimeve dhe parime të tjera udhëzuese të cilat duhet të ushtrohen nga Agjencitë e Zbatimit të Ligjit kur këto masa aplikohen;



- Të sigurohet kuadri ligjor në tëresi në legjislacionin e brendshëm në respektim të parimeve të KEDNJ, në veçanti në segmentin e ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale (KPP) të BH dhe të kantoneve të saj. Kryesisht harmonizimi i legjislacionit të kantoneve dhe përkufizimi i saktë i veprave penale (katalog i veprave penale) për të cilat mund të përdoren MPH-të;
- Të prezantohen gjatë harmonizimit të legjislacionit të brendshëm dispozita të cilat do të rregullojnë në mënyrë preçize bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me përdorimin e MPH-ve, në veçanti kur bëhet fjalë për skuadrat e përbashkëta hetimore dhe operacionet ndër-kufitare, në lidhje me përdorimin e MPH-ve dhe mundësinë për këmbimin e agjentëve të fshehtë;
- Të adoptohen udhëzime të brendshme për zbatimin e MPH-ve specifike, duke përfshirë procedurat mbi agjentët e fshehtë dhe oficerët e tjerë të zbatimit të ligjit të cilët punojnë në këto punë të përmendura, si dhe për zyrtarët drejtues të cilët udhëheqin dhe aprovojnë përfshirjen e disa prej oficerëve;
- Të adoptohen udhëzime dhe rregullore të brendshme për zyrtarët e zbatimit të ligjit që punojnë me informatorët e regjistruar;

#### Kuadri Institucional

##### *Objektivat afat shkurtër dhe afat mesme*

- Të sigurohet ngritja në nivel shtetëror e një njësie të pavarur e cila do të mbledhë dhe analizojë të dhënat në mënyrë sistematike mbi përdorimin e MPH-ve; do të identifikojë mënyrën më të mirë të aplikimit të MPH-ve, duke patur parasysh të gjitha kapacitetet e disponueshme; do të publikojë raporte periodike dhe vjetore mbi përdorimin e MPH-ve;
- Të institucionalizohet segmenti i financimit dhe përdorimit të mjeteve financiare gjatë aplikimit të MPH-ve me qëllim sigurimin e kontrollit të efektshëm mbi shpenzimet e mjeteve buxhetore;
- Të adoptohet kuadri rregullues (i brendshëm) i cili dikton përdorimin e mjeteve financiare për operacionet e fshehta, agjentët dhe informatorët e fshehtë, dhe që do të sigurojë një mbikëqyrje të efektshme mbi shpenzimet e këtyre mjeteve;
- Të konsiderohen modele të ndryshme të mekanizmave të jashtëm mbikëqyrës mbi përdorimin e MPH-ve (përveç kontrollit gjyqësor, ose nëpërmjet komiteteve të posaçme mbikëqyrëse, komiteteve të posaçme parlamentare, Avokatit të Popullit, etj);
- Të sigurohet bashkëpunimi i ngushtë midis prokurorëve, gjyqtarëve të procedurave paraprake dhe agjensive të zbatimit të ligjit në procesin e aplikimit të MPH-ve, ndërkohë që bashkëpunimi midis agjensive dhe këmbimi i të dhënave në BH rregullohet nga Ligjet e BH, Kantoneve dhe Rrethit të Brcko-s;
- Të ngrihen departamente/njësi të specializuara të zbatimit të ligjit për trajtimin e operacioneve me agjentë të fshehtë;
- Të forcohet bashkëpunimi midis agjensive të zbatimit të ligjit, në veçanti midis AShHM-së dhe Ministrive të Brendshme të kantoneve, Policisë së Rrethit të Brcko-s dhe Zyrës së Prokurorisë të BH;
- Të ngrihet kontrolli i brendshëm i detyrueshëm në institucione/agjensi në të cilat ende nuk egziston, dhe të rritet ky kontroll në institucionet ku tashmë është në funksionim;
- Të rriten kapacitetet e stafit të ministrive kompetente (Ministria e Sigurisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Civile) dhe të arrihet afirmimi i plotë i tyre në ushtrimin e kompetencave të parashikuara.

##### *Objektivat afat gjatë*

- Të përmirësohet bashkëpunimi ndërkombëtar në lidhje me përdorimin e MPH-ve, në veçanti për sa i përket fushës së këmbimit të agjentëve të fshehtë.

#### Edukimi

- Të institucionalizohet trajnimi i përgjithshëm mbi MPH-të për oficerët përkatës të zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjykatësit që merren me aktivitetet e lidhura me përdorimin e MPH-ve;
- Të institucionalizohen trainime të posaçme për agjentët e fshehtë dhe për oficerët e zbatimit të ligjit që menaxhojnë dhe drejtojnë agjentët e fshehtë.

#### **4. Krijimi i mekanizmave efektive për mbrojtjen e dëshmitarëve të krimeve të rënda**

## Kuadri Ligjor

### *Objektivat afat shkurtra dhe afat mesme*

- Të sigurohet zbatimi i Ligjit mbi mbrojtjen e dëshmitarëve të rrezikuar dhe të dëshmitarëve të kërcënuar dhe Ligjit mbi programin e mbrojtjes së dëshmitarëve; nëpërmjet zbatimit të tyre të sigurohet zbatimi ligjor i masave procedurale dhe jo-procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve në Bosnje dhe Hercegovinë, si dhe të sigurohen nevojat financiare për zbatimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve.

## Kuadri Institucional

### *Objektivat afat shkurtra dhe afat mesme*

- Të sigurohet funksionimi i plotë i Njesisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve e cila është ngritur brënda ASHM (Agjensia Shtetërore e Hetimeve dhe Mbrojtjes) (përfundimi i procesit të marrjes në punë të stafit dhe arritja e kapacitetit të plotë veprues, sigurimi i mjeteve financiare për paisjen me mjete teknike, përfundimi i trainimeve të përgjithshme dhe të specializuara për të gjithë nëpunësit e Njesisë dhe sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të Njesisë);
- Të përgatitet adoptimi i rregullave dhe procedurave rreth punës së Njesisë për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke përdorur praktikën më të mira të vëndeve me eksperiencë në zbatimin e masave procedurale dhe jo-procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe përshtatja e tyre në kuadrin ligjor të Bosnje dhe Hercegovinës;
- Të ndërtohet bashkëpunim i përhershëm me agjensitë e zbatimit të ligjit në nivel kantonesh (Ministrisë së Brëndshme të RS, Ministrisë së Brëndshme të Federatës së BH), në nivel shtetëror (SBS, OSA, INTERPOL) si dhe me Policinë e Rrethit të Brcko-s të BH-së;
- Të sigurohet dhe të vazhdohet bashkëpunimi i përhershëm me Regjistrarin, me të cilin Njësia e ASHM-së për mbrojtjen e dëshmitarëve ka bërë një marrëveshje bashkëpunimi dhe mbështetjeje;
- Të sigurohen kapacitetet teknike në sallat e gjyqit që do të mundësonin dhënien e dëshmive nëpërmjet lidhjeve me video, duke përfshirë dhe trainimin praktik të gjyqtarëve dhe prokurorëve për pranimin e rregullave në përputhje me procedurat ndërkombëtare gjatë përdorimit të mjeteve teknike për dëshmitë e dhëna me lidhje me video;
- Të ndërtohet bashkëpunimi me Njësitet për mbrojtjen e dëshmitarëve nga rajoni, në mënyrë që të standartizohen rregullat dhe procedurat për masat e mbrojtjes së dëshmitarëve, në veçanti për masën e rivendosjes së dëshmitarëve brënda rajonit të Europës Jug – Lindore;
- Të sigurohen marrëveshjeve dy-palëshe dhe shumë-palëshe për bashkëpunim në shtypjen e krimit të organizuar, që nënkupton forcimin e bashkëpunimit për sa i përket cilësisë së zbatimit të programeve për mbrojtjen e dëshmitarëve në vëndet e rajonit dhe rivendosjen e dëshmitarëve të mbrojtur në vënde të treta;
- Të ngrihet kontrolli i brëndshëm i detyrueshëm në institucione/agjensi në të cilat ende nuk egziston, dhe të rritet ky kontroll në institucionet ku tashmë është në funksionim;
- Të rriten kapacitetet e stafit të ministrive kompetente (Ministria e Sigurisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Civile) dhe të arrihet afirmimi i plotë i tyre në ushtrimin e kompetencave të parashikuara.

## Edukimi

- Të zbatohen programe praktike për edukimin e prokurorëve, gjykatësve dhe avokatëve mbrojtës në fushën e masave procedurale që lidhen me programet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe masave mbështetëse për dëshmitarët e mbrojtur.

### **5. Forcimi i kapaciteteve për bashkëpunim në çështjet penale me theksin tek Protokollin i Dytë Shtesë të Konventës Evropiane mbi Ndhimën e Ndërsjellë në Fushën Penale**

#### Kuadri Ligjor

- Të miratohet një Ligj mbi Ndhimën Ligjore në Fushën Penale. Dispozitat e Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës Evropiane mbi Ndhimën e Ndërsjellë në Fushën Penale duhet të zbatohen në këtë Ligj, me theks të veçantë në kanalet e komunikimit, duke përfshirë dhe shërbimet me postë, transferimin e përkohshëm të personave të paraburgosur dhe prezencën e zyrtarëve të palës kërkuese gjatë sigurimit të ndihmës ligjore e të tjera të ngjashme me këto;
- Të kryhen ndryshime dhe shtesa në Kodin e Proçedurës Penale të Bosnje dhe Hercegovinës, Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës, Republikës Srpska dhe Rrethit Brcko, sidomos në pjesën që lidhet me mundësinë e seancave me video konferencë, shërbimin drejt vënde të huaja të informacionit të drejtpërdrejtë të mbledhur gjatë hetimeve të veta, mbikëqyrjet ndër-kufitare, transportimin e kontrolluar, hetimet e fshehta, skuadrat e përbashkëta të hetimit e të tjera të ngjashme me këto;
- Të kryhen ndryshime në Ligjin mbi Shërbimin Kufitar Shtetëror, në Ligjin mbi Agjensinë Shtetërore të Hetimeve dhe Mbrojtjes, në Ligjin mbi Shërbimin Informativ Shtetëror dhe Agjensinë e Sigurisë, Ligjin e Çështjeve të Brëndshme të Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës, Ligjin e Çështjeve të Brëndshme të Republikës Srpska dhe Rrethit të Brcko-s të Bosnje dhe Hercegovinës në çështjet që lidhen me mbikëqyrjen ndër-kufitare, transportimin e kontrolluar dhe hetimet e fshehta.

#### Kuadri Institucional

- Të ndërtohet bashkëpunim i përhershëm midis Ministrisë së Drejtësisë së Bosnje dhe Hercegovinës, Ministrisë së Drejtësisë së Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës, Ministrisë së Drejtësisë së Republikës Srpska, NCB Interpol-it dhe organeve të zbatimit të ligjit;
- Të nënshkruhen marrëveshjeve administrative midis institucioneve kompetente me fokus në zbatimin e këtij Protokollin, veçanërisht në pjesën që lidhet me skuadrat e përbashkëta të hetimit;
- Të sigurohen kapacitete teknike në gjykata për mundësimin e seancave me video konferencë;
- Të organizohen seminare dhe ëorkshop-e me fokus në edukimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e ndihmës ligjore në çështje penale;
- Të sigurohen burime financiare për këtë qellim në buxhetet e Bosnje dhe Hercegovinës, Republikës Srpska dhe Rrethit të Brcko-s.

## 2.3 KROACIA

### 1. Rritja e kapaciteteve për analizën e krimit dhe të të dhënave mbi krimin

*Objektivat afat shkurtër dhe afat mesëm*

Kuadri Ligjor

- Të përmirësohet zbatimi i dispozitave të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe Protokollit Shtesë të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse dhe kalimin përmes kufinjve të të dhënave informative;

Kuadri Institucional

- Të forcohen njësitet e analizimit të krimit duke siguruar trainime të avancuara në lidhje me analizimin e krimit të organizuar dhe ekonomik (strategjik dhe operacional) dhe të ndërmerren masa të tjera në këtë drejtim sipas nevojve të identifikuara;
- Të ngrihet një sistem (i njësuar) kombëtar ose një rrjet sistemesh për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave kriminale të cilat marrin në konsideratë tiparet specifike të krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të zhvillohet një metodologji e përbashkët për agjensitë e zbatimit të ligjit për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave kriminale të cilat marrin në konsideratë tiparet specifike të krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të sigurohet që kontributet standarte të informacionit janë të detyrueshme nga institucione të posaçme të zbatimit të ligjit.

*Objektivat afat gjatë*

Politikat

- Të bashkëpunohet me komunitetin shkencor dhe akademik (p.sh. Akademia e Policisë dhe Fakulteti i Kriminalogjisë) për analizimin e aspekteve të krimit të organizuar, tendencave, rrethanave, grupeve dhe teknologjive;
- Të mbështetet zhvillimi i kërkimeve të pavarura dhe institucioneve, të cilat ndërmarrin studime në fusha të ndryshme në lidhje me krimin e organizuar dhe ekonomik, duke u siguruar informacion të përshtatshëm dhe lloj tjetër ndihme kur është e mundur;
- Të prezantohet monitorimi i rregullt i efektshmërisë së masave për ndalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe ekonomik (p.sh. raporte vjetore dhe mbikëqyrje të posaçme ndër –institucionale dhe parlamentare).

Bashkepunimi ndërkombëtar

- Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e analizimit të krimit nëpërmjet mundësisë të këmbimit në mënyrë të ligjshme dhe operacionale të informacioneve të përshtatshme midis autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit, me qëllim mbledhjen dhe ndarjen e informacionit, hetimeve dhe ndihmës së përbashkët ligjore, në përputhje me rregullat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave.

### 2. Forcimi i kapaciteteve të hetimeve financiare me synim konfiskimin e produkteve të krimit

- Si pjesë e një reforme në vazhdim ndaj Kodit të Proçedurës Penale të konsiderohet paraqitja e një detyrimi ligjor për policët dhe prokurorët për të filluar dhe mbaruar hetimet financiare në mënyrë paralele me ato penale në rastet kur kemi të bëjmë me krime të rënda;
- Si pjesë e një reforme në vazhdim ndaj Kodit të Proçedurës Penale të rishikohet sistemi i masave të përkohëshme për sigurimin e të ardhurave të dyshuara nga krimi dhe për të siguruar se këto

masa (ngrirja e të ardhurave, sekuestrimi) mund të urdhërohen në faza shumë të herëshme të hetimeve policore;

- Të adoptohet një akt nën-ligjor, duke zbatuar rregulloren që detajon detyrimet, shpërndarjen e detyrave, procedurat, koordinimin dhe bashkëpunimin ndër-institucional në hetimet financiare;
- Të krijohet një agjensi/institucion i posaçëm i mandatuar për zbatimin e urdhrave të sekuestrimit dhe konfiskimit dhe menaxhimin e pronave të sekuestruara dhe konfiskuara;
- Të rritet dhe institucionalizohet bashkëpunimi dhe komunikimi midis njësive që hetojnë krimin ekonomik dhe pastrimin e parasë dhe njësive të ngarkuara për luftimin e krimit të organizuar dhe krimit të lidhur me drogën duke krijuar një Njësi të specializuar për Hetimet Financiare dhe Pastrimin e Parasë (ose në një afat të shkurtër caktimi i oficerëve të specializuar për këtë detyrë)
- Të rritet ndërgjegjësimi – nëpërmjet trainimeve bazë – mbi konceptin e hetimeve të ndërlidhura financiare dhe kriminale midis policisë, prokurorëve dhe gjykatësve;
- Të institucionalizohen trainimeve të vazhdueshme të specializuara në ndërmarrjen e hetimeve financiare për policinë, prokurorët dhe gjykatësit hetues.

### **3. Forcimi i kuadrut ligjor dhe i kapaciteteve zbatuese në lidhje me përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore**

- Të ndryshohet Kodi i Proçedurës Penale në lidhje me mangësitë tashmë të identifikuara për pasurim e përdorimit të MPH-ve;
- Të adoptohen rregullore të brëndshme që rregullojnë: procedurat e autorizimit të brëndshëm, rregullat e mbajtjes së të dhënave dhe rregullat e trajtimit të materialeve të siguruara, masat që sigurojnë fshehtësinë e hetimeve dhe parime të tjera udhëzuese të cilat duhet të ushtrohen nga Agjensitë e Zbatimit të Ligjit gjatë ushtrimit të këtyre masave dhe të rezultateve të tyre;
- Të rregullohet përdorimi i burimeve financiare në aplikimin e MPH-ve duke adoptuar një kuadër rregullues (të brëndshëm) të detajuar i cili do të diktonte përdorimin e burimeve në aplikim e MPH-ve në veçanti në lidhje me financimin e operacioneve, agjentëve dhe informatorëve të fshehtë, dhe që do të siguronte një mbikëqyrje të efektshme mbi përdorimin e këtyre fondeve;
- Të sigurohet ndarja institucionale e mbikëqyrjes së kryer nga autoritetet e zbatimit të ligjit me qëllim hetimet penale dhe e mbikëqyrjes së kryer nga shërbimet informative me qëllim sigurinë kombëtare; dhe tu sigurohen autoriteteve publike të zbatimit të ligjit burime njerëzore dhe teknike për të zbatuar MPH-të në mënyrë të pavarur nga burimet e sigurimit të shtetit ose institucionet;
- Të sigurohen paisje për ndërhyrjen në komunikime nëpërmjet rrjeteve kompjuterike;

### **4. Krijimi i mekanizmave efektive për mbrojtjen e dëshmitarëve të krimeve të rënda**

- Të sigurohet një financim i mëtejshëm dhe i qëndrueshëm i programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve;
- Të vazhdohet të rritet ndërgjegjësimi midis policisë, prokurorëve si dhe institucioneve të tjera shtetërore përkatëse në lidhje me mundësitë dhe kufizimet e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve;
- Të përfundohet paisja e njësisë së mbrojtjes së dëshmitarëve dhe trajnimi i stafit të saj;
- Të forcohet bashkëpunimi dhe komunikimi midis policisë dhe prokurorëve në fushën e zbatimit të masave procedurale dhe jo-procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Të zbatohen programe praktike trajnimi për prokurorët dhe gjykatësit rreth masave procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Të shtohen kapacitetet teknike të gjykatave për të shfrytëzuar dëshmitë e dhëna nëpërmjet lidhjeve me video;
- Të sigurohet se marrëveshjet dy-palëshe mbi bashkëpunimin në fushën e shtypjes së krimit të organizuar përfshijnë dispozita që mundësojnë bashkëpunimin në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve.

**5. Forcimi i kapaciteteve për bashkëpunim në çështjet penale me theksin tek Protokollin i Dytë Shtesë të Konventës Evropiane mbi Ndihmën e Ndërsjellë në Fushën Penale**

Republika e Kroacisë ka nënshkruar Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës Evropiane mbi Ndihmën e Ndërsjellë në Fushën Penale (në vijim Shtojcën e Dytë) më 9 Qershor 2004.

Më 1 Korrik 2005, ka hyrë në fuqi Akti mbi Ndihmën e Ndërsjellë Ligjore në Fushën Penale (në vijim Akti NPL).

Dispozitat e Aktit NPL në shumë aspekte janë në përputhje me Shtojcën e Dytë si:

- Zmadhimi i gamës së të adresuarve ndaj të cilëve i adresohet Shtojca e Dytë, veçanërisht entet ligjore,
- Zgjerimi i juridiksionit të NPL-s për sa i përket procedurave të keqbërjes të sjella nga autoritetet administrative,
- Futja e mundësisë së komunikimit të drejtpërdrejtë midis autoriteteve gjyqësore dhe e mundësisë së shërbimit të dokumentave nëpërmjet postës,
- Prezenca e zyrtarëve të palës kërkuese, sipas kërkesës, gjatë zbatimit të kërkesës,
- Transferimi i përkohëshëm i personave të paraburgosur në territorin e palës kërkuese,
- Zbatimi i shtyre i kërkesave,
- Informacioni i rastësishëm, dëshmipërblimi, etj.

Ministria e Drejtësisë është momentalisht në procesin e përfundimit të harmonizimit të plotë të Aktit të NPL-së me dispozitat e Shtojcës së Dytë në lidhje me mbikëqyrjet ndër-kufitare, transportimin e kontrolluar, hetimet e fshehta, skuadrat e përbashkëta të hetimit, etj.

Për më tepër Akti i NPL-së është pjesërisht i harmonizuar me Konventën Evropiane mbi NPL në Çështje Penale midis Shteteve Antare nga viti 2000. Qellimi i Ministrisë së Drejtësisë është që të përfundojë shumë shpejt harmonizimin me këtë Konventë dhe më instrumenta të tjera legislative të Bashkimit Europian të lidhura me këtë çështje.

## 2.4 SERBIA DHE MALI I ZI / MALI I ZI

### 1. Rritja e kapaciteteve për analizën e krimit dhe të të dhënave mbi krimin

*Objektivat afat shkurtër dhe afat mesme*

Kuadri Ligjor

- Të nënshkruhen dhe ratifikohen dispozitat e Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe Protokollit Shtesë së Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse dhe kalimin përmes kufinjve të të dhënave informative.

Kuadri Institucional

- Të përfundohet ngritja e njësisë së analizimit të krimit, të rekrutohet një numër i përshtatshëm analistësh dhe të sigurohet trainim mbi analizën e krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të ngrihet një sistem (i njësuar) kombëtar ose një rrjet sistemesh për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave kriminale të cilat marrin në konsideratë tiparet specifike të krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të zvillohet një metodologji e përbashkët për agjensitë e zbatimit të ligjit për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave kriminale të cilat marrin në konsideratë tiparet specifike të krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të sigurohet se kontributi standard i informacionit në bazën e të dhënave të policisë kriminale është i detyrueshëm nga institucionet e caktuara të zbatimit të ligjit.

*Objektivat afat gjatë:*

Politika

- Të mbështetet zhvillimi i kapaciteteve të komunitetit shkencor dhe akademik (p.sh. Akademia e Policisë dhe Fakulteti i Kriminalogjisë) për analizimin e aspekteve të krimit të organizuar, tendencave, rrethanave, grupeve dhe teknologjive;
- Të mbështetet zhvillimi i kërkimeve të pavarura dhe institucioneve, të cilat ndërmarrin studime në fusha të ndryshme në lidhje me krimin e organizuar dhe ekonomik, duke u siguruar informacion të përshtatshëm dhe lloj tjetër ndihme kur është e mundur;
- Të prezantohet monitorimi i rregullt i efektshmërisë së masave për ndalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe ekonomik (p.sh. raporte vjetore dhe mbikëqyrje të posaçme ndër-institucionale dhe parlamentare).

Bashkëpunimi ndërkombëtar

- Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e analizimit të krimit nëpërmjet mundësimit të këmbimit në mënyrë të ligjshme dhe operacionale të informacioneve të përshtatshme midis autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit, me qëllim mbledhjen dhe ndarjen e informacionit, hetimeve dhe ndihmës së përbashkët ligjore, në përputhje me rregullat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave.

### 2. Forcimi i kapaciteteve të hetimeve financiare me synim konfiskimin e produkteve të krimit

*Objektivat afat shkurtër dhe afat mesme:*

- Të përfundohet një Memorandum Mirëkuptimi, Komunikimi dhe Shkëmbimi informacioni duke përfshin policinë, Zyrën e Prokurorisë, Njësinë e Doganave, Administratën së Taksave dhe Shërbimit Informativ Financiar që do të përcaktonte në mënyrë të detajuar kompetencat, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në rastet e hetimeve financiare;
- Të përfundohen marrëveshje të reja dy-palëshe, apo të përshtaten ato egzistueset, të nënshkruara nga Ministri i Brëndshëm me policitë e vëndeve të tjera në fushën e bashkëpunimit

ne luftën kundër krimit të organizuar, duke siguruar ndërkohë që bashkëpunimi në hetimet financiare mbulohet nga marrëveshje të tilla;

- Të ndiqen rekomandimet e mekanizmave vlerësues në fushën e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit (MONEYVAL, GRECO);
- Të caktohet një numër inspektorësh në Departamentin e Krimit Ekonomik, veçanërisht për hetimet financiare;
- Të caktohet një numër prokurorësh për tu specializuar për hetime financiare;
- Të prezantohet një detyrim për policinë për të filluar një hetim financiar paralelisht me hetimet penale për të gjitha veprat penale që përfshijnë një shumë të caktuar të dyshuar si përfitim kriminal;
- Të ndërtohet një rrjet oficerësh policie dhe prokurorësh të specializuar në hetime financiare;
- Të ndërtohet një regjistër të centralizuar për pronat e sekuestruara dhe të konfiskuara nga Gjykata;
- Të ndërmarren trainime me ndihmën e ekspertëve të huaj dhe të shërbimeve policore të specializuara të huaja, për oficerë policie dhe prokurorë të zgjedhur, që më vonë të shërbejnë si trajnerë për zyrtarë të tjerë Malazez;
- Të organizohen dhe të institucionalizohen trainime bazë mbi hetimet financiare për policinë, prokurorët dhe gjykatësit.

*Objektivat afat gjata:*

- Të studiohet mundësia për të prezantuar përqasjen e zgjatur të konfiskimit në legjislacion dhe në qoftë se është e aplikueshme të përgatisë ndryshimet në Kodin Penal;
- Të përgatiten ndryshimet legjislative në Kodin e Proçedurës Penale për mundësuar marrjen e informacionit të drejtpërdrejtë bankar dhe informacionit rreth transfertave bankare nga ana e policisë dhe prokurorisë;
- Të studiohen mundësitë për ndryshimin e Kodit të Proçedurave Penale për të mundësuar përdorimin e disa mjeteve të posaçme të hetimit me qëllim identifikimin e të ardhurave nga krimi;
- Të studiohen mundësitë për futjen në legjislacion të konfiskimit pa ndëshkim në disa rrethana të caktuara;
- Të ndërtohet një Agjensi qendrore jashtë policisë, e ngarkuar me menaxhimin dhe kujdesjen e pronave të sekuestruara dhe konfiskuara;
- Të studiohen nevojat dhe mundësitë për ndërtimin e një njësie të specializuar brënda policisë, e cila do të fokusohet vetëm në hetimet financiare;
- Të studiohen nevojat dhe mundësitë për ndërtimin e një njësie të specializuar brënda Zyrës së Prokurorisë, e cila do të fokusohet vetëm në hetimet financiare;
- Të institucionalizohet trainimi i vazhdueshëm i policisë, prokurorëve dhe gjykatësve mbi hetimet financiare.

**3. Forcimi i kuadrit ligjor dhe i kapaciteteve zbatuese në lidhje me përdorimin e mjeteve të posaçme financiare**

- Të ndryshohet Neni 237 i Kodit të Proçedurës Penale për të adresuar paqëndrueshmëritë dhe mangësitë në lidhje me kushtet kërkua për urdhërimin e MPH-ve;
- Të ndryshohet Neni 238 i Kodit të Proçedurës Penale për të mundësuar përdorimin e MPH-ve dhe për disa vepra për të cilat dënimi është parashikuar më pak se 10 vjet burgim;
- Të ndërtohen njësi të specializuara policore për zbatimin e Mjeteve të Posaçme të Hetimit;
- Të adoptohen udhëzime/akte nën-ligjore të brëndshme që rregullojnë: proçedurat e autorizimit të brëndshëm, rregullat e mbajtjes së të dhënave dhe rregullat e trajtimit të materialeve të siguruar, masat që sigurojnë fshehtësinë e hetimeve dhe parime të tjera udhëzuese;
- Të adoptohen udhëzime dhe rregullore të brëndshme për ndërmarrjen e operacioneve të fshehta, duke përfshirë menaxhimin dhe drejtimin e agjentëve të fshehtë;
- Të adoptohen udhëzime të brëndshme për zyrtarët e zbatimit të ligjit që punojnë me informatorë të regjistruar;
- Të krijohet një sistem raportimi kombëtar mbi përdorimin e MPH-ve;
- Të adoptohet kuadri (i brëndshëm) rregullues i cili dikton përdorimin e burimeve financiare në lidhje me zbatimin e mjeteve të posaçme hetimore, financimin e operacioneve, agjentëve dhe informatorëve të fshehtë, dhe që do të siguronte një mbikëqyrje të efektshme mbi përdorimin e këtyre fondeve;



- Të studiohen modele të ndryshme të mekanizmave të jashtëm mbikëqyrës me qëllim prezantimin e mekanizmave sistematik të jashtëm mbikëqyrës për përdorimin e MPH-ve (përveç mbikëqyrjes gjyqësore), ose nëpërmjet paneleve të posaçme mbikëqyrëse gjyqësore, komisioneve të posaçme parlamentare, Avokatit të Popullit ose formave të tjera;
- Të organizohet një trajnim i përgjithshëm mbi MPH-të për zyrtarët e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjykatësit që merren me to;
- Me ndihmën e ekspertëve të huaj dhe njesive të specializuara të huaja, të trajnohen trajnerët në fushën e shpërndarjes dhe trajtimit të agjentëve të fshehtë;
- Në varësi të kapaciteteve financiare ti sigurohen policisë burimet njerëzore dhe teknike për zbatimin e MPH-ve në mënyrë të pavarur nga institucionet shtetërore të sigurisë;
- Të përmirësohet bashkëpunimi ndërkombëtar në lidhje me përdorimin e MPH-ve.

#### **4. Krijimi i mekanizmave efektive për mbrojtjen e dëshmitarëve të krimeve të rënda**

- Të sigurohet vënia në funksionim e Njesisë së sapo ngritur për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (NjMD);
- Ti sigurohen NjMD-së paisjet e përshtatshme nëpërmjet ndihmës së huaj;
- Të trajnohen stafi i NjMD-së;
- Të sigurohet financimi i qëndrueshëm i programeve për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Të ndërtohet dhe të paiset të paktën një seli/sallë gjyqi në vend më mjete telekomunikacioni për të mundësuar dëshminë ndër-kufitare me lidhje me video;
- Të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë duke lehtësuar egzaminimin e dëshmitarëve përtej kufinjve, duke përfunduar marrëveshje që mundësojnë rivendosjen e dëshmitarëve dhe duke siguruar se programet vëndase të mbrojtjes së dëshmitarëve janë të hapura dhe ndaj dëshmitarëve të huaj.

#### **5. Forcimi i kapaciteteve për bashkëpunim në çështjet penale me theksin tek Protokollin i Dytë Shtesë të Konventës Europiane mbi Ndihmën e Ndërsjellë në Fushën Penale**

- Të ratifikohet Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës Europiane mbi Ndihmën e Përbashkët në Çështje Penale;
- Të ngrihet një trup i posaçëm i cili do të jetë i përgjegjshëm për bashkëpunimin dhe ndihmën ligjore ndërkombëtare në çështje të krimit të organizuar.

## 2.5 SERBIA DHE MALI I ZI / SERBIA

### 1. Rritja e kapaciteteve për analizën e krimit dhe të të dhënave mbi krimin

*Objektivat afat shkurtra dhe afat mesme:*

Kuadri Ligjor

- Të nënshkruhen dhe ratifikohen dispozitat e Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe Protokollit Shtesë së Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse dhe kalimin përmes kufijve të informacionit;
- Të kalohet një Akt mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili është në përputhje me Konventën dhe Protokollin Shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës dhe Direktivës 95/46 të Këshillit dhe Parlamentit Evropian;
- Të miratohet një Akt mbi mbajtjen Sekret të të Dhënave i cili është në përputhje me standardet bashkëkohore Evropiane.

Kuadri Institucional

- Të ngrihet një sistem (i njësuar) kombëtar ose një rrjet sistemesh për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave kriminale të cilat marrin në konsideratë tiparet specifike të krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të ndërtohen njësi për analizën e krimit atje ku këto njësi nuk ekzistojnë në të gjitha segmentet e shtypjes së krimit, të sigurohen trajnime të cilësisë së lartë mbi analizimin e krimit, sidomos krimit të organizuar dhe ekonomik (strategjik dhe operacional) dhe të merren në konsideratë tiparet specifike të krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të zvillohet një metodologji e përbashkët për agjencitë e zbatimit të ligjit për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave kriminale të cilat marrin në konsideratë tiparet specifike të krimit të organizuar dhe ekonomik;
- Të sigurohet se informacioni mbledhet dhe depozitohet në bazën e të dhënave sipas mënyrave standarde dhe se kjo procedurë është e detyrueshme për policinë kriminale dhe institucionet specifike të zbatimit të ligjit.

*Objektivat afat gjata:*

Politika

- Të bashkëpunohet me komunitetin shkencor dhe akademik (p.sh. Akademia e Policisë dhe Fakulteti i Kriminalogjisë) për analizimin e aspekteve të krimit të organizuar, tendencave, rrethanave, grupeve dhe teknologjive;
- Të mbështetet zhvillimi i kërkimeve të pavarura dhe institucioneve, të cilat ndërmarrin studime në fusha të ndryshme në lidhje me krimin e organizuar dhe ekonomik, duke u siguruar informacion të përshtatshëm dhe lloj tjetër ndihme kur është e mundur;
- Të ushtrohet monitorimi i rregullt i efektshmërisë së masave për ndalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe ekonomik nga përfaqësuesit e Parlamentit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

- Të mbahet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e analizimit të krimit nëpërmjet mundësimit të këmbimit në mënyrë të ligjshme dhe operacionale të informacioneve të përshtatshme midis autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit, me qëllim mbledhjen dhe ndarjen e informacionit, hetimeve dhe ndihmës së përbashkët ligjore, në përputhje me rregullat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave.

### 2. Forcimi i kapaciteteve hetimore financiare me qëllim konfiskimin e të ardhurave nga krimi

- Të prezantohet në Kodin Penal konfiskimi i detyruar i të ardhurave të krimit mbas dhënies së dënimit;
- Të zgjerohen dhe forcohen dispozitat të cilat mundësojnë konfiskimin e të dhënave dhe nga palë të treta dhe persona juridikë;
- Të adoptohet legjislacioni që prezanton përgjegjshmëri kriminale të përbashkët – përgjegjshmëri kriminale-ligjore të personave juridikë;
- Të ndryshohet kuadri ligjor aktual në mënyrë që të munësohet konfiskimi i pasurisë dhe të lëvizet barra e provës nga prokurorët – shteti te të akuzuarit;
- Të konsiderohet prezantimi në legjislacionin i një procedure të veçantë për konfiskimin e të ardhurave të krimit në mënyrë që të shmangen vonesat në procedurat penale;
- Duke ndryshuar Ligjin për Ndalimin e Pastrimit të Parasë t'u jepet e drejta njëjësive të shërbimit informativ financiar (NjIF) për të patur një kohë reale të fshehtë për monitorimin e transaksioneve financiare dhe për të kryer një pezullim të përkohëshëm të transaksioneve;
- Të rishikohen dispozitat e Kodit të Proçedurës Penale me qëllim përmirësimin e efikasitetit të masave të përkohëshme për sekuestrimin e të ardhurave të krimit;
- Të adoptohet një legjislacion që dikon në detaje menaxhimin e pronave të sekuestruara e konfiskuara dhe të ndërtohet një agjensi e specializuar;
- Të konsiderohet ndryshimi i Kodit Penal dhe i Kodit të Proçedurës Penale në mënyrë që të mundësohet konfiskimi i të ardhurave nga krimi dhe pa patur paraprakisht një dënim të dhënë për raste shumë të kufizuara (p.s. raste korrupsioni, pastrim parash, vdekje të autorit të veprës);
- Të shtohet puna në zbatimin e detyrimeve të ndërmarra gjatë ratifikimit dhe aderimit në konventat ndërkombëtare që lidhen me këtë fushë;
- Të merren masat e nevojshme në mënyrë që të eliminohen të gjitha difektet e sistemit të dhëna në raportin e vlerësimit të parë të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Europës;
- Të prezantohet koncepti i hetimeve financiare në legjislacionin dhe të konsiderohet ndryshimi i Kodit të Proçedurës Penale për të mundësuar përdorimin e MPH-ve me qëllim identifikimin e të ardhurave nga krimi;
- Të sigurohet specializimi në fushën e hetimeve financiare brënda policisë, prokurorisë dhe gjykatave;
- Të sigurohet kuadri institucional për task-forcat që punojnë me hetimet financiare dhe të studiohen mundësitë e ndërtimit të një njësie për hetime financiare të specializuar në shumë drejtime;
- Të krijohet një regjistër i centralizuar për të ardhurat e sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi;
- Të zhvillohen trajnime për agjensitë e përgjegjshme për kryerjen e hetimeve financiare, që do të fokusoheshin në mundësitë e legjislacionit aktual i cili është në pritje të adoptimit të ndryshimeve legjislative.

### **3. Forcimi i kuadrit ligjor dhe i kapaciteteve zbatuese në lidhje me përdorimin e mjeteve të posaçme financiare**

- Të adoptohen zyrtarisht kriteret e CARPO-s mbi MPH-të si një kuadër i përshtatshëm për ndryshime legjislative;
- Brënda ndryshimeve të Kodit të Proçedurës Penale të harmonizohen me standartet Europiane dispozitat që lidhen me MPH-të;
- Të finalizohet dhe të adoptohet Urdhri Ekzekutiv mbi Detyrat e Operatorëve të Telekomunikacionit në lidhje me ndërhyrjen e ligjshme në telekomunikacione. Të jepet Projekt Dispozita mbi Detyrimet e Operatorëve të Telekomunikacionit në lidhje me ndërhyrjet e ligjshme në telekomunikacione mbas opinioit të dhënë për adoptim Qeverisë së Republikës së Serbisë nga Këshilli i Europës dhe OSBE;
- Të zbatohet projekti për ndërtimin dhe paisjen e Qendrës për monitorimin e telekomunikacionit në Ministrinë e Brëndshme të Republikës së Serbisë, duke siguruar një ndarje institucionale të mbikëqyrjes së telekomunikacionit të kryer nga autoritetet e zbatimit të ligjit për arsye të hetimeve penale nga mbikëqyrja e kryer nga shërbimet informative për arsye të sigurisë kombëtare;
- Të ndërtohet një njësi policore e specializuar për shpërndarjen e agjentëve të fshehtë;
- Të institucionalizohet një trajnim i vazhdueshëm për antarët e agjensisë rreth MPH-ve dhe të sigurohet një kontroll ligjor mbi përdorimin e MPH-ve;
- Të institucionalizohet një trajnim i veçantë i agjentëve të fshehtë dhe i zyrtarëve të zbatimit të ligjit që menaxhojnë dhe drejtojnë agjentët e fshehtë;
- Të adoptohet kuadri rregullues (i brëndshëm) i cili do të rregullonte punën e agjentëve të fshehtë, përgatitjen e operacioneve dhe veçanërisht përdorimin e detajuar të burimeve financiare (p.sh. në

formën e fondeve të specializuara) për aplikimin e MPH-ve, në veçanti për sa i përket financimit të operacioneve, agjentëve dhe informatorëve të fshehtë. Është e nevojshme të sigurohet me akte nën-ligjore një mbikëqyrje efiçente mbi përdorimin e këtyre fondeve;

- Të përmirësohet mbledhja sistematike dhe analiza e informacionit mbi përdorimin e MPH-ve dhe të përmirësohet përpunimi nga një autoritet i lartë i pavaruar i një raporti vjetor mbi përdorimin e MPH-ve, me detyrimin për të respektuar parimet e fshehtësisë;
- Të bëhen publike raportet statistikore vjetore mbi përdorimin e MPH-ve, me një përmbledhje të veçantë rreth numrit të masave të aplikuara dhe numrit të çështjeve të proçeduara;
- Të adoptohen udhëzime dhe rregullore të brendshme për kryerjen e operacioneve të fshehta;
- Të adoptohen rregullore të detajuara që diktojnë trajtimin dhe shkatërrimin e materialeve dhe të dhënave personale të siguruar nëpërmjet përdorimit të MPH-ve, si dhe një lajmërim të mundshëm në vijim të objektivave për përdorimin e këtyre masave.

#### **4. Krijimi i mekanizmave efektive për mbrojtjen e dëshmitarëve të krimeve të rënda**

- Të adoptohet ligji për mbrojtjen e dëshmitarit, i cili do të detajonte në mënyrë preçize të gjithë mekanizmat e mbrojtjes së dëshmitarit në proçedurat penale;
- Të institucionalizohen mekanizmat e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në proçedurat penale të mbrojtjes së dëshmitarit;

#### **5. Forcimi i kapaciteteve për bashkëpunim në çështjet penale me theksin tek Protokoli i Dytë Shtesë të Konventës Evropiane mbi Ndhimën e Ndërsjellë në Fushën Penale**

- Të ratifikohet Protokoli i Dytë Shtesë i Konventës Evropiane mbi Ndhimën e Ndërsjellë në Fushën Penale;
- Të ngrihet një trup i posaçëm i cili do të jetë i përgjegjshëm për bashkëpunimin dhe ndihmën ligjore ndërkombëtare në çështjet e krimit të organizuar.

## 2.6 SERBIA DHE MALI I ZI / KOSOVA

### 1. Rritja e kapaciteteve për analizën e krimit dhe të të dhënave mbi krimin

*Objektivat afatshkurtra / afatgjata:*

Kuadri ligjor

- Të miratohen dispozitat e Konventës për Mbrojtjen e Individëve në raport me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, si dhe të Protokollit Shtesë të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, që i referohen autoriteteve mbikqyrëse dhe kalimit ndërkufitar të të dhënave.

Kuadri Institucional

- Të merret në konsiderate zhvillimi i kapaciteteve lokale (p.sh. të oficerëve të policisë kosovare) për analizën e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik (strategjike dhe operacionale);
- Të merret në konsiderate ngritja e një sistemi, apo e një rrjeti të unifikuar sistemesh për mbledhjen e të dhënave dhe të statistikave mbi krimin, të cilat duhet të marrin parasysh tiparet specifike të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik;
- Të merret në konsideratë zhvillimi i një metodologjie të përbashkët për agjencitë e zbatimit të ligjit, në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe statistikave mbi krimin, të cilat duhet të marrin parasysh tiparet specifike të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik;
- Të garantohet që kontributet e informacionit, sipas një formati standard për bazën e të dhënave të policisë janë të detyrueshme për organe të specifikuar të zbatimit të ligjit.

*Objektivat Afatgjata*

Politika

- Të mbështeten kapacitetet për zhvillim të komuniteteve lokale shkencore dhe akademike (p.sh. Akademia e Policisë dhe Fakulteti i Kriminologjisë) për të analizuar aspektet e krimit të organizuar, prirjet, rrethanat, grupet dhe teknologjitë;
- Të mbështeten kapacitetet për zhvillim të institucioneve të pavarura kërkimore të cilat ndërmarrin kërkime shumëdisiplinëshe mbi krimin e organizuar dhe krimin ekonomik, duke u dhënë informacione me vlerë si dhe cdo lloj mbështetjeje tjetër, kur kjo është e mundur;
- Të futet monitorimi sistematik i efektivitetit të masave për parandalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik (p.sh. raportet vjetore, dhe kontrolli i specializuar i parlamentar, ose ndër-institucional).

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

- Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e analizës së krimit, duke mundësuar shkëmbimin ligjor dhe operacional të informacioneve të vlefshme, ndërmjet autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit me qëllim mbledhje dhe shkëmbimin e informacionit, zhvillimin e hetimeve dhe ndihmën e ndërsjellë ligjore, në pajtim me rregullat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave.

### 2. Fuqizimi i kapaciteteve të hetimeve financiare që synojnë konfiskimin e produkteve të krimit

- Të lejohet lëshimi i urdhërave për zbulim të informacionit financiar nga prokurori dhe të përfshihen dispozita specifike në Kodin e Procedurës Penale të cilat do t'u mundësojnë hetuesve të marrin informacione aktuale nga institucionet financiare;
- Të përcaktohet nëse dispozitat e Rregullores për Pastrimin e Parave që lidhen me konfiskimin e përkohshëm dhe të përhershëm të përfitimeve materiale që burojnë nga aktivitetet kriminale janë zëvendësuese të dispozitave mbi konfiskimin të Kodit të Procedurës Penale;

- Ngritja e një njësie, nën kontrollin e Departamentit të Ministrisë së Drejtësisë që do të jetë përgjegjëse për ruajtjen e provave të mbledhura gjatë një hetimi penal, duke përfshirë sendet e konfiskuara përkohësisht, në cilësinë e përfitimeve materiale të mundshme nga një aktivitetet kriminal. Njësia duhet të ketë ambiente të gjera dhe të sigurt, në secilin nga pesë qarqet administrative të Kosovës për magazinimin e pasurive të luajtshme, të tilla si makina, mobilje dhe mallra të tjera, si dhe duhet të ketë llogari bankare të veçanta, për sigurimin e parave të kapura gjatë hetimeve penale. Njësia duhet të përdorë një sistem të kompjuterizuar që lidhet me një regjistër qendror, i cili mund të ofrojë informacion të menjëhershëm dhe të rifreskuar, në lidhje me vlerën dhe vendndodhjen e pasurive të konfiskuara;
- Ngritja e një njësie të përhershme, të specializuar dhe të ngarkuar me detyrën e gjurmimit të pasurive dhe të identifikimit të produkteve të aktiviteteve kriminale. Kjo njësi do të kryejë të gjitha hetimet financiare për rastet e krimeve të mëdha, por do të marrë pjesë gjithashtu në trajnimet e policëve dhe të prokurorëve. Hetimet financiare për rastet më pak të spikatura do të menaxhohen nga “oficerët ndërlidhës” në çdo qark administrativ, të cilët, do të kryejnë, përveç detyrave të tyre policore, edhe hetime financiare, duke marrë ndihmën e nevojshme të hetuesve të njësisë;
- Prokurorë të specializuar në fushën e kimit ekonomik dhe financiar dhe krijimi i sektorëve të kimit ekonomik në secilin zyrë të prokurorive të rretheve. Këta prokurorë do të menaxhojnë përfitimet materiale në të gjitha hetimet për çështje të rëndësishme. Këta prokurorë do të marrin pjesë gjithashtu në trajnimet e policëve dhe të prokurorëve;
- Përfshirja në mënyrë të përhershme e një kursi shtesë (i cili do të mund të përfshihet si një modul i një kursi të përparuar mbi hetimet financiare) në shkollën e policisë, i cili do të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme. Fillimisht, ky trajnim do të kryhet me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë dhe të oficerëve të huaj të policisë, të trajnuar në fushën e hetimeve financiare. Me zhvillimin e kompetencave, trajnimi duhet të kryhet nga hetues vendas, të trajnuar më parë mbi hetimet financiare, (kurse të trajnimit të trajnerëve) dhe nga prokurorë publikë që zhvillojnë hetime financiare.
- Zhvillimi i një sistemi të akreditimit për profesionistët të cilët dëshirojnë të shërbejnë si ekspertë. Ata profesionistë që do të përmbushin standardet e akreditimit do të vihen në një listë, e cila do të konsultohet nga gjykatat dhe nga prokurorët, sipas nevojave të rastit.

### **3. Fuqizimi i kuadrit ligjor dhe i kapaciteteve zbatuese në lidhje me përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore**

- Në kuadër të rishikimit aktual të Dispozitave të Kodit të Procedurës Penale (PCPCK), të rishikohen dispozitat ekzistuese që kanë lidhje me MPH-të;
- Të garantohet mundësia e zbatimit të masave të mbrojtjes së dëshmitarit për dëshmitë që paraqiten nga agjentët e fshehtë, duke përcaktuar nëse masat mbi mbrojtjen e dëshmitarit, të parashikuara nga PCPCK janë të mjaftueshme dhe nëse një ndryshim në udhëzimet e politikës mund t'i zbusë shqetësimet ekzistuese; alternativisht, duhet të përcaktohet nëse kërkohet një ndryshim në ligj, për t'i zgjidhur këto çështje;
- Të rishikohen katalogjet ekzistuese mbi veprat penale në PCPCK, dhe të përcaktohet nëse gama dhe pragu i përdorimit të MPH-ve të caktuara mund të përfshijë edhe vepra të tjera penale;
- Të zhvillohet një Procedurë Standarde e Operimit (SOP), e cila t'i përkushtohet posaçërisht menaxhimit dhe asgjësimit të materialit të përfituar me anë të MPH-ve;
- Të finalizohen dhe të miratohen udhëzime në lidhje me menaxhimin e informatorëve dhe të agjentëve të fshehtë;
- Të futet parimi i mbledhjes dhe analizimit sistematik të informacionit mbi përdorimin e MPH-ve dhe të sigurohet hartimi nga ana e një autoriteti të lartë dhe të pavarur të raporteve vjetore mbi përdorimin e të gjitha llojeve të MPH-ve;
- Të merret në konsideratë ngritja e njësie të specializuara për përdorimin e agjentëve të fshehtë;
- Të futen në sistem mekanizma të jashtëm për mbikqyrjen e përdorimit të MPH-ve, mundësisht me anë të Njësisë Standarde Profesioniste;
- Të zhvillohen trajnime të mëtejshme mbi MPH-të për prokurorë dhe gjyqtarë;
- Të zhvillohen trajnime të institucionalizuara për oficerët që punojnë në departamentet e specializuara të kimit të organizuar, me qëllim që të arrihen 2 qëllime: 1) të bëhen trajnime më të gjithanshme mbi MPH-të, të cilat mund të arrihen me anë të kualifikimeve në kuadër të punës, brenda njësie të specializuara; dhe 2) të krijohen premisa për mbylljen e hendekut, që mund të krijohet kur të largohet stafi ndërkombëtar, kur ende stafi lokal që është trajnuar, nuk është në pozicionin që të kryejë rolin e trajnerit;

- Të vazhdohet me lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe, të cilat do ta shtrijnë përdorimin e MPHve dhe në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

#### **4. Krijimi i mekanizmave efektive për mbrojtjen e dëshmitarëve të krimeve të rënda**

- Në kuadër të rishikimit actual të Kodit të Procedurës Penale (PCPCK), të rishikohen dispozitat aktuale që lidhen me masat procedurale mbrojtëse;
- Të përgatiten dhe të miratohen ligje/rregullore speciale që rregullojnë masat jo-procedurale të mbrojtjes së dëshmitarëve, që themelojnë formalisht njësinë për mbrojtjen e dëshmitarëve, që trajtojnë *inter alia* çështjet e shpërnguljes së përhershme, ndryshimit të identitetit dhe masa të tjera për mbrojtjen fizike;
- Të garantohen pajisjet teknike të përshtatshme për dhënien e dëshmive, me anë të masave teknologjike sikurse parashikohet në PCPCK;
- Të garantohet se masat jo-procedurale për mbrojtjen e dëshmitarit, gjejnë zbatim në favor të dëshmitarëve bashkëpunues;
- Të vazhdohet me zbatimin e strategjisë së tranzicionit për NjMD-në, duke rekrutuar dhe trajnuar Shërbimin Policor të Kosovës (ShPK-në) për të punuar në NjMD;
- Me ndihmën e ekspertëve të huaj dhe të shërbimeve të huaja të specializuara të trajnohen trajnerë për NjMD-në;
- Të vazhdohet me zbatimin e Marrëveshjes dypalëshe për Transferimin e Dëshmitarëve, e cila do të lehtësojë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së dëshmitarit dhe të transferimit të dëshmitarit;
- Të garantohet se Marrëveshjet për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale që nënshkruhen me shtetet, përmbajnë dispozita që mundësojnë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së dëshmitarit.

#### **5. Fuqizimi i kapaciteteve për bashkëpunimin në fushën penale, me theksin tek Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale**

- Në raport me nenin (14) të merret në konsideratë ndryshimi i PCPCK në lidhje me përgjegjshmërinë e personave juridikë për veprat penale;
- Në raport me nenin (3) të merret në konsideratë futja e një dispozite të re në PCPCK, në lidhje me transferimin e përkohshëm të shtetasve të huaj, të ndaluar;
- Të rishikohet neni 533 i PCPCK dhe të përcaktohet se transferimi i përkohshëm mund të ndodhë kur (a) ka një marrëveshje ndërkombëtare që lejon transferimin e një banori të Kosovës në një juridiksion të huaj, me përjashtim të rasteve, kur ka garanci të mjaftueshme se prova që kërkohet nga personi nuk ka lidhje me krimin, për të cilin po zhvillohen hetime; dhe (b) kur kriteret e propozuara nga Neni 517A janë përmbushur;
- Të rishikohet neni 508 i PCPCK, për të lejuar Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë të Departamentit të Drejtësisë t'i drejtojë kërkesa autoritetit kompetent;
- Në raport me nenin 5, të miratohet një nen që ka lidhje me shpenzimet;
- Të rishikohet neni 506 i PCPCK me qëllim që të pasqyrohen dispozitat e ekzekutimit të vonuar të kërkesave, (neni 7) dhe procedurat (neni 8);
- Të ndryshohet PCPCK, me qëllim që të reflektohen dispozitat e nenit 11, që lidhen me informacionin spontan;
- Të merret në konsideratë bërja e ndryshimeve specifike në dispozitat e përgjithshme mbi MPH-të në PCPCK, me qëllim që të lejohen dorëzimet e kontrolluara me kërkesë të një Pale tjetër;
- Në raport me zbatimin e nenit 20, të ndryshohen dispozitat ekzistuese, me qëllim që të fiksohet korniza për ngritjen dhe operimin e ekipeve të përbashkëta hetimore;
- Të ndryshohet PCPCK, me qëllim që të pasqyrohen dispozitat thelbësore të nenit 23 mbi mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Të ndryshohet PCPCK me qëllim që të pasqyrohen dispozitat e nenit 24 mbi masat e përkohshme me qëllim ruajtjen e provave, ruajtjen e situates ekzistuese, ose mbrojtjen e interesave të ligjshme të rrezikuara;
- Të ndryshohet PCPCK, me qëllim që të përmbushen kriteret e konfidencialitetit;
- Të ndryshohet PCPCK, me qëllim që të pasqyrohen dispozitat thelbësore për mbrojtjen e të dhënave (neni 26);
- Të fuqizohen kapacitetet institucionale dhe operacionale;
- Të trajnohen gjyqtarët dhe juristët mbi ligjini për ndihmë të ndërsjellë në fushën penale dhe në zhvillimin e kapaciteteve për përkthim.

## 2.7 “ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË”

### 1. Rritja e kapaciteteve për analizën e krimit dhe të dhënave mbi krimin

*Objektivat afatshkurtra / afatgjata:*

Kuadri ligjor

- Të përmirësohet zbatimi i dispozitave të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale si dhe të Protokollit Shtesë të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave personale, përsa i takon autoriteteve mbikqyrëse dhe rrjedhjes rajonale të të dhënave.

Kuadri Institucional

- Të fuqizohen njësitë e analizës së krimit, duke rekrutuar një numër të përshtatshëm analistësh si dhe duke ndërmarrë trajnime mbi analizën e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik;
- Të ngrihet një sistem kombëtar (i njësuar) ose një rrjet i njësuar sistemesh për grumbullimin e të dhënave dhe statistikave që kanë lidhje me krimin, të cilat duhet të marrin parasysh tiparet specifike të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik;
- Të përpunohet një metodologji e përbashkët për agjencitë e zbatimit të ligjit për mbledhjen e të dhënave dhe të statistikave që kanë lidhje me krimin, e cila duhet të marrë parasysh tiparet specifike të krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik;
- Të garantohet që kontributi standard i informacionit të jetë i detyrueshëm për institucionet e caktuara të zbatimit të ligjit.

*Objektivat afatgjata:*

Politika

- Të bashkëpunohet me komunitetet akademike dhe shkencore (si psh. Akademia e Policisë dhe Fakulteti i Krimnologjisë) për të analizuar aspektet e krimit të organizuar, prirjet e tij, rrethanat në të cilat zhvillohet, grupet dhe teknologjitë që përdor.
- Të mbështetet zhvillimi i kërkimeve të pavaruara dhe i institucionve që kryejnë kërkime shumë-disiplinëshe mbi krimin e organizuar dhe krimin ekonomik duke u dhënë informacionet e duhura si dhe çdo lloj ndihme tjetër të mundshme.
- Të parashikohet monitorimi sistematik i efektivitetit të masave që kanë lidhje me parandalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik (si p.sh. me anë të raporteve vjetore, apo të një kontrolli parlamentar ose kontrollit të specializuar ndër-institucional).

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e analizës së krimit, duke mundësuar nga pikëpamja ligjore dhe operationale shkëmbimin e informacioneve të vlefshme, ndërmjet autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit me qëllim grumbullimin dhe shkëmbimin e informacioneve, zhvillimin e hetimeve dhe ndihmën e ndërsjellë ligjore, në pajtim me rregullat përkatëse që lidhen me mbrojtjen e të dhënave.

### 2. Fuqizimi i kapaciteteve të hetimeve financiare që synojnë konfiskimin e produkteve të krimit



- Të merret në konsideratë zgjerimi i pasurimit të paligjshëm, të ngjashme me atë të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit nga funksionarët tek personat e dyshuar për kryerjen e krimeve të rënda, duke miratuar parimin e zhvendosjes së barrës së proves, në lidhje me konfiskimin e produkteve të krimit;
- Të miratohet një kuadër rregullativ i hollësishëm, (ligje dhe rregullore të brendshme) mbi ekzekutimin e urdhërave të konfiskimit dhe të sekuestrimit dhe mbi trajtimin dhe menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe mbi krijimin e një agjencie të specializuar për këtë detyrë;
- Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet Departamentit kundër Krimit të Organizuar të Policisë, Departamentit të të Ardhurave Publike, Policisë Financiare, Administratës së Doganave, Drejtorisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit duke miratuar memorandume bashkëpunimi dhe komunikimi, si dhe duke institucionalizuar një qasje prej task-force dhe mbledhje sistematike strategjike, taktike dhe operacionale;
- Në interesin e përdorimit të mire të burimeve të kufizuara të minimizohet fenomeni i mbivendosjes së kompetencave dhe juridiksioneve si dhe të ndiqet parimi i komplementaritetit (plotësimi të njëri-tjetrit) ndërmjet policisë financiare dhe policisë kriminale;
- Të vijohet me sensibilizimin – me anë të trajnimeve bazë dhe seminareve me vendimmarrësit – në lidhje me konceptin e harmonizimit të hetimeve penale me hetimet financiare;
- Të ngrihet një regjistër i centralizuar të produkteve të kapura dhe të konfiskuara;
- Të organizohen dhe të zbatohen trajnime të specializuara mbi hetimet financiare për praktikuesit e të gjitha niveleve dhe për institucionet përkatëse.

### **3. Fuqizimi i kuadrit ligjor dhe i kapaciteteve zbatuese në lidhje me përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore**

- Në vijim të miratimit të Ligjit për Interceptimin e Telekomunikimeve të ngrihet Njësia e Survejimit Elektronik dhe të sigurohen burime të përshtatshme njerëzore dhe teknike për punën e kësaj njësie;
- Të sigurohen burime njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për Njësinë e Informatorëve dhe Bashkëpunëtorëve Operacionalë;
- Të miratohen udhëzime/akte të brendshme nënligjore që rregullojnë procedurat e brendshme të autorizimit, rregullat për mbajtjen e dosjeve, rregullat për menaxhimin e materialit të përfituar, rregullat që sigurojnë konfidencialitetin e hetimeve, dhe parime të tjera udhërrëfyese;
- Të miratohen udhëzime dhe rregullore të brendshme për drejtimin e operacioneve të fshehta, duke përfshirë menaxhimin dhe drejtimin e agjentëve të fshehtë;
- Të krikohet një sistem kombëtar raportimi mbi përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore (MPHve);
- Të miratohet një kuadër ligjor (i brendshëm) që rregullon përdorimin e burimeve financiare që lidhen me financimin e operacioneve të fshehta, agjentëve dhe informatorëve si dhe të sigurohet një kontroll efikas mbi përdorimin e këtyre fondeve;
- Të institucionalizohen dhe të zbatohen trajnime të specializuara për zyrtarët që punojnë në Sektorët e MPH-ve;
- Të institucionalizohen trajnime specifike për agjentët e fshehtë dhe për zyrtarët e zbatimit të ligjit që menaxhojnë dhe drejojnë agjentët e fshehtë.

### **4. Krijimi i mekanizmave efektive për mbrojtjen e dëshmitarëve të krimeve të rënda**

- Të garantohet zbatimi i Ligjit të miratuar së fundmi mbi Mbrojtjen e Dëshmitarit, deri në vitin 2006, duke ndjekur projektin e miratuar për bërjen plotësisht operacionale të Njesisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (NjMD) deri në vitin 2007 (projekti identifikon masat specifike që lidhen me hartimin dhe miratimin e rregulloreve të brendshme, rekrutimin e stafit, garantimin e pajisjeve, dhe në mënyrë të veçantë me trajnimin e specialistëve);
- Të përgatiten dhe të miratohen Rregullat e Procedurës për Komisionin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve;

- Të përgatiten dhe të miratohen rregullore të brendshme në lidhje me funksionimin e Njesisë për Mbrojtjen e Dëshmitarit: regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave personale; financimin; formularët dhe pyetësorët për dëshmitarët e mbrojtur;
- Të organizohen, me asistencën e ekspertëve të huaj dhe shërbimeve të huaja, trajnime të specializuara për punonjësit që punojnë në NjMD në fushat e mëposhtëme: zhvillimi i intervistave me kandidatët për të hyrë në program, vlerësimi i rreziqeve, elementët e domosdoshëm të memorandumit mbi hyrjen në program; aspektet psikologjike që rezultojnë nga afrimi me personat e futur në program, etj;
- Të garantohet financim i vazhdueshëm për NjMD, ashtu sikurse parashikohet në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarit;
- Të garantohen pajisje për dhënien e dëshmimeve me anë të videos, dhe të kryhen trajnime mbi përdorimin e këtyre pajisjeve me prokurorë dhe gjyqtarë.

***5. Fuqizimi i kapaciteteve për bashkëpunim në fushën penale, me theksin tek Protokollin i Dytë / Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale***

**Qëllimet afat-shkurtra**

- Me qëllim që të nxitet bashkëpunimi ndër-institucional dhe bashkëpunimi me shërbime të tjera të sigurimit në arenën ndërkombëtare, është e domosdoshme të organizohen seminare, takime pune dhe trajnime të formave të tjera për autoritetet policore, autoritetet e prokurorisë, dhe gjyqësorin me qëllim zbatimin më efikas të rregullave ekzistuese.

Kjo duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda vitit 2005, ose deri në gusht të vitit 2006, deri në castin kur projekti CARDS do të përfundojë, me qëllim që të harmonizohet kuadri ligjor me rregullat dhe standardet evropiane.

**Qëllimet afat-gjata**

- Si qëllim afat-gjatë, do të mund të përmendej domosdoshmëria e miratimit të ligjeve të reja dhe të ndryshimit apo të plotësimit të atyre ekzistuese, të cilat trajtojnë çështjet e diskutuara më sipër, me qëllim përmirësimin e tyre.

**Kuadri kohor**

Është planifikuar që kjo Strategji të jetë një strategji afat-shkurtër dhe ndoshta është më mire që ajo të zbatohet për një periudhë tre-vjecare, sepse do të dalin në pah të gjitha avantazhet dhe mosavantazhet e zbatimit të saj në praktikë.